



Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

18 shkurt 2007

Raport i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it



Varshavë
5 qershor 2007

PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJE	1
II.	HYRJE DHE FALENDERIME	3
III.	KONTEKSTI POLITIK	3
IV.	SISTEMI ZGJEDHOR	4
V.	KUADRI LIGJOR	5
VI.	ADMINSITRATA ZGJEDHORE	6
	A. ORGANET E AMINISTRATËS ZGJEDHORE	6
	B. VLERËSIM I ORGANIZIMIT TË ZGJEDHJEVE	7
VII.	REGJISTRIMI I KANDIDATËVE	8
VIII.	REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE	9
IX.	CERTIFIKATAT E LINDJES	11
X.	FUSHATA ZGJEDHORE	12
XI.	MEDIA	13
	A. KUADRI RREGULLUES	13
	B. MONITORIMI I MEDIAS NGA MVZ-JA E OSBE/ODIHR-IT	14
XII.	PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE	15
XIII.	PJESËMARRJA E GRAVE	15
XIV.	VËZHGESIT VENDAS JOPARTIAKË	16
XV.	ANKIMET DHE APELIMET PARAZGJEDHORE	16
XVI.	VOTIMI DHE NUMËRIMI	17
	A. VOTIMI	17
	B. NUMËRIMI I VOTAVE.....	19
XVII.	SHPALLJA E REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE	21
XVIII.	ANKIMET DHE APELIMET PASZGJEDHORE	21
	A. SHQYRTIMI I ANKIMEVE PASZGJEDHORE NGA KQZ-JA	21
	B. SHQYRTIMET E APELIMEVE PASZGJEDHORE NGA KOLEGJI ZGJEDHOR	22
XIX.	ZGJEDHJET E PËRSËRITURA, 6 MAJ 2007	25
XX.	REKOMANDIME	26
	A. PARTITË POLITIKE	26
	B. KUADRI LIGJOR	26
	C. SISTEMI ZGJEDHOR.....	27
	D. ADMINISTRATA ZGJEDHORE.....	27
	E. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE	27
	F. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE DHE IDENTIFIKIMI I TYRE	28
	G. MEDIA	28
	H. VOTIMI DHE NUMËRIMI	29
	I. ANKIMET DHE APELIMET.....	29
	J. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE	29
	K. PJESËMARRJA E GRAVE	30
	L. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE.....	30
	RRETH OSBE/ODIHR-IT	31

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE
18 shkurt 2007

Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it¹

I. PËRMBLEDHJE

Në përgjigje të një ftese nga Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të caktuara për t'u zhvilluar fillimisht më 20 janar 2007 dhe ricaktuar më vonë për datën 18 shkurt 2007, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) ngriti një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) në Republikën e Shqipërisë më 13 dhjetor 2006². MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vlerësoi procesin zgjedhor përsa i përket përputhshmërisë me Angazhimet e OSBE-së dhe standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Për vëzhgim në ditën e zgjedhjeve, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it bashkoi përpjekjet me një delegacion nga Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Evropës i Këshillit të Evropës (KAVRE) për ngritjen e një Misioni Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ).

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2007 i përmbushën vetëm pjesërisht Angazhimet e OSBE-së dhe standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Ndonëse këto zgjedhje siguruan kushtet për një garë konkurruese, përbën shqetësim fakti se partitë kryesore politike të Shqipërisë, edhe njëherë, vendosën interesa partiake afatshkurtra dhe të ngushta mbi stabilitetin dhe besueshmërinë e procesit të zgjedhjeve.

Partitë politike kryesore të Shqipërisë dështuan, në një shkallë të madhe, në përmbushjen e përgjegjësisë dhe detyrave të konsiderueshme që u ishin dhënë gjatë përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve. Për rrjedhojë, procesi zgjedhor, shpesh u bllokua dhe dukej të ishte pranë pikës së kolapsit në raste të përsëritura. Si pasojë, zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore u desh të shtyheshin për afërsisht një muaj nga data fillestare 20 janar 2007.

Ngërçi politik në zhvillimin e procesit zgjedhor u zgjidh pas një marrëveshjeje të vonuar politike më 12 janar 2007, që u hapí rrugën ndryshimeve në Kushtetutë dhe Kodin Zgjedhor ditën e nesërme. Kjo marrëveshje u arrit nën kujdesin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë me mbështetjen e fortë të Bashkësisë Ndërkombëtare të akredituar në Tiranë. Nisma e Kryetarit të rradhës së OSBE-së, Ministri i Jashtëm spanjoll, Miguel Angel Moratinos, i cili dërgoi në Tiranë të dërguarin e tij të posaçëm, Ambasadorin Jose Pons, për të lehtësuar dialogun, ishte shumë e dobishme në këtë drejtim.

Kryetarët dhe këshillat e 384 njësive të qeverisjes vendore (NjQV) zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë. Kryetarët zgjidhen në bazë të parimit fiton kush renditet i pari, ndërsa këshilltarët zgjidhen në bazë të një sistemi proporcional. Ndryshimet e janarit 2007 krijuan mundësinë që partitë dhe koalicionet të ndryshojnë renditjen e kandidatëve në listë pas ditës së zgjedhjeve. Kjo nuk është në përputhje me standarde ndërkombëtare, pasi zgjedhësit nuk e dinë se cilët kandidatë do të zgjidhen nga mbështetja e tyre për një parti apo koalicion të caktuar. Dispozita të ngjashme

¹ Ky raport është i përkthyer në gjuhën shqipe. Sidoqoftë, varianti në gjuhën angleze mbetet i vetmi dokument zyrtar.

² Të gjithë Raportet e mëparshëm mbi Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Shqipëri mund të gjenden në www.osce.org/odihr

për zgjedhjet për Kuvendin janë kritikuar më parë nga OSBE/ODIHR-i për shkak se ulin transparencën dhe bien ndesh me Angazhimet e OSBE-së dhe standarde ndërkombëtare.

Kuadri ligjor, në përgjithësi, siguron një bazë të qendrueshme për zgjedhje demokratike, për sa kohë partitë politike tregojnë vullnet të mjaftueshëm për zbatimin e tij me besimin e mirë. Megjithatë ndryshimet në kuadrin ligjor të datës 13 janar 2007 erdhën si rrjedhojë e një marrëveshjeje politike të minutës së fundit dhe jo si një përpjekje për një reformë zgjedhore të plotë e të gjerë, ato trajtuan një numër rekomandimesh të mëparshme të OSBE/ODIHR-it. Megjithatë, ato futën edhe dispozita që provuan të ishin problematike dhe komplekse, në veçanti lidhur me identifikimin e zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve.

Marrëveshja e vonuar dhe ndryshimet vijuese në Kod çuan në afate të ngjeshura ligjore, që sollën sfida të mëdha logjistike dhe administrative për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Pavarësisht nga sfidat, KQZ-ja i administroi këto zgjedhje në një shkallë të madhe me profesionalizëm dhe paanshmëri. Komisionet Zgjedhore të Qeverisjes Vendore (KZQV) u prekën nga ushtrimi i gjerë i së drejtës së partive politike për të zëvendësuar të propozuarit e tyre në çdo kohë dhe pa arsyetim. Gjithashtu, emërimi i vonë i Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV) dhe Grupeve të Numërimit (GN) uli efikasitetin e tyre, dhe shumë anëtarë të tyre nuk morën trajnimin zyrtar.

Regjistrimi i kandidatëve ishte përfshirës. Megjithatë, vetëm 33 nga 1 073 kandidatë për kryetarë ishin femra. Ashtu si në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005, procesi i verifikimit të nënshkrimeve mbështetëse nuk ishte i rregulluar dhe mbeti i pakënaqshëm.

Pati përmirësim të matshëm në listat e zgjedhësve në krahasim me zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005. Në veçanti, shumë rekorde të shumëfishta u fshinë. Megjithatë, bashkëpunimi midis Ministrisë së Brendshme dhe NjQV-ve nuk ishte gjithmonë pa probleme, në pjesën më të madhe të rasteve për shkak të ndërhyrjeve të partive politike. Certifikatat e lindjes, që përdoren gjerësisht si mjet identifikimi, përfshirë edhe për qëllime zgjedhore, ishin, edhe një here, një çështje polemikash. Gjithashtu, dispozitat kalimtare për identifikimin e zgjedhësve emigrantë, provuan të ishin problematike, duke qenë se ishin diskriminuese dhe nuk u zbatuan në mënyrë të njëtrajtshme.

Fushata zgjedhore ishte aktive në gjithë vendin dhe kandidatët vërejtën pak probleme lidhur me mundësinë e tyre për të bërë fushatë. Vetëm pak incidente u vërejtën, përfshirë disa incidente të dhunshme të izoluar. Pati pretendime në masë të gjerë për abuzim të burimeve administrative për fushatë, që në përgjithësi nuk mund të provoheshin.

Media elektronike dhe ajo e shkruar i pasqyruan gjerësisht zgjedhjet. Ndonëse para fillimit të fushatës zgjedhore, media elektronike e monitoruar nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it favorizonte qartësisht parti të caktuara, pasqyrimi i veprimtarive të tyre u bë më i barazpeshuar gjatë periudhës së fushatës zyrtare.

Para ditës së zgjedhjeve shyrtimi i ankimeve zgjedhore ishte përgjithësisht transparent dhe adekuat. Megjithatë, ky proces degradoi pas ditës së zgjedhjeve, me një prirje për të votuar sipas vijave partiake në KQZ, dhe u vërejtën disa raste të mungesës së njëtrajtshmërisë në vendimet e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë lidhur me ankimet kundër vendimeve të KQZ-së.

Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë dhe zgjedhjet u administruan me profesionalizëm në pjesën më të madhe të Qendrave të Votimit (QV) të vizituara nga vëzhguesit ndërkombëtarë. Megjithatë, vëzhguesit vërejtën mangësi proceduriale dhe, në një numër NjQV-shë, një shkallë

tensioni. Përgjithësisht, vëzhguesit e vlerësuan procesin e votimit 'keq' ose 'shumë keq' në 10 për qind të QV-ve të vizituara.

Procesi i numërimit u vlerësua 'keq' ose 'shumë keq' në 23 për qind të Vendeve të Numërimit të Votave (VNV) të vizituara. Shpesh, vëzhgues të partive dhe deputetë ndërhyjnë apo u përpoqën të ndërhyjnë në proces. Për pasojë, u krijuan tensione dhe u vërejtën disa incidente të dhunshme. Në pak raste, për shkak të bllokimeve, KQZ-së iu desh të urdhëronte KZQV-të të sillnin të gjitha materialet zgjedhore në Tiranë, në mënyrë që të përfundohej numërimi.

Më 6 maj 2007, u zhvillua përsëritja e zgjedhjeve në 20 NjQV. Pavarësisht nga emërime dhe zëvendësime të shumta të minutës së fundit, si procesi i votimit ashtu edhe ai i numërimit ishin përgjithësisht të kënaqshëm. Përsëritje të zgjedhjeve u zhvilluan gjithashtu edhe në 3 qershor 2007 në NjQV-të Pult dhe Shalë.

Policia i kreu detyrat në mënyrë profesionale gjatë gjithë procesit dhe veçanërisht bëri punë të lavdërueshme gjatë procesit të numërimit të votave.

II. HYRJE DHE FALENDERIME

Pas një ftese nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, caktuar fillimisht për t'u zhvilluar më 20 janar 2007 dhe ricaktuar për datën 18 shkurt 2007, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) ngriti një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) në Republikën e Shqipërisë më 13 dhjetor 2006. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it, kryesuar nga z. Jørgen Grunnet, përbëhej nga 33 ekspertë dhe vëzhgues afatgjatë (VAGj) nga 15 Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. Zgjedhjet vendore të 18 shkurtit 2007 në Republikën e Shqipërisë ishin të tretat në vend të vëzhguara nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR).

Për vëzhgim ditën e zgjedhjeve, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it bashkoi forcat me një delegacion vëzhgimi nga Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Evropës i Këshillit të Evropës për ngritjen e një Misioni Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ). Z. Jean-Claude Frécon kryesoi delegacionin e Kongresit. Ditën e zgjedhjeve, 345 vëzhgues afatshkurtër nga 39 Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së u dërguan në kuadrin e MNVZ-së, përfshirë 17 vëzhgues nga Kongresi. Vëzhguesit e MNVZ-së ndoqën votimin në 1 084 qendra votimi nga 4 721 gjithsej, që ndodhen në 247 prej 384 njësiteve të qeverisjes vendore. Gjithashtu, vëzhguesit e MNVZ-së vëzhguan numërimin e votave në 77 vende të numërimit të votave nga 375 ku u krye numërimi.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it i shpreh falenderimet e saj Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe autoriteteve të tjera shtetërore dhe vendore për ndihmesën dhe bashkëpunimin e tyre. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it dëshiron të shprehë falenderimin e saj edhe për Prezencën e OSBE-së në Shqipëri për mbështetjen e dhënë gjatë kohëzgjatjes së misionit si dhe Ambasadave të Shteteve pjesëmarrëse në OSBE të akredituara në Tiranë.

III. KONTEKSTI POLITIK

Që prej zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2005, Qeveria është drejtuar nga Kryeministri Sali Berisha, kryetari i Partisë Demokratike (PD). Shumica qeverisëse përfshin gjashtë parti të tjera që, megjithatë së bashku, nuk kanë vendet e mjaftueshme në Kuvend për të kontrolluar shumicën

prej tre të pestave (84 vota nga 140) të nevojshme për të miratuar apo ndryshuar legjislacion kyç, përfshirë Kodin Zgjedhor. Kështu, opozita pesëpartiake, udhëhequr nga z. Edi Rama, kryetar i Partisë Socialiste (PS), ka qenë në gjendje të bllokojë miratimin e ndryshimeve në Kod sa herë që ata nuk kanë qenë dakord me qëndrimin e Qeverisë. Për këtë arsye, në vijim të dështimit të bisedimeve ndërpartiake mbi reformën zgjedhore në vitin 2006, opozita ka qenë në gjendje të paralizojë procesin me efektshmëri.

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2007 u shtynë me afro një muaj nga 20 janari 2007, data e dekretuar fillimisht nga Presidenti i Republikës, z. Alfred Moisiu. Pas një periudhe të zgjatur të përplasjeve politike midis dy poleve kryesore politike, më në fund më 12 janar³, u gjet një zgjidhje politike e krizës, që mundësoi të nesërmen miratimin e ndryshimeve në Kushtetutë dhe Kodin Zgjedhor. Nisma e Kryetarit të rradhës së OSBE-së, Ministri i Jashtëm spanjoll, Miguel Angel Moratinos, i cili dërgoi në Tiranë të dërguarin e tij të posaçëm Ambasadorin Jose Pons për të lehtësuar dialogun, ishte shumë e dobishme në këtë drejtim. Më 14 janar, Presidenti Moisiu rishpalli datën e zgjedhjeve për më 18 shkurt.

Mjedisi politik ka vazhduar të jetë i ngarkuar së tepërmi dhe i ndarë midis dy partive më të mëdha politike; Partisë Demokratike, që udhëheq shumicën qeverisëse, dhe Partisë Socialiste, në opozitë. Antagonizmi i vazhdueshëm midis këtyre dy partive ka çuar shpesh në ngërçe të zgjatura politike dhe kriza të shpeshta. Përgjithësisht, klima politike vazhdoi të karakterizohej nga një mungesë e konsiderueshme e besimit që e bën të vështirë ndërtimin e konsensusit. Si rrjedhojë, bashkësia ndërkombëtare thirret shpesh për të ndërmjetësuar në rast mosmarrëveshjesh.

IV. SISTEMI ZGJEDHOR

Kryetarët dhe këshilltarët e njësisve të qeverisjes vendore (NjQV)⁴ zgjidhen drejtpërdrejt nga zgjedhës me vendbanim në NjQV-në përkatëse. Nëpërmjet një ndryshimi kushtetues më 13 janar 2007, mandati i autoriteteve të qeverisjes vendore u zgjat nga tre në katër vjet, në përputhje me Rekomandimet e Përbashkëta të vitit 2004 nga Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës dhe OSBE/ODIHR-i.

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore zhvillohen me një raund të vetëm votimi, me fletë të veçanta për garat për kryetarë dhe këshilltarë. Kandidatët për kryetarë zgjidhen në bazë të parimit fiton kush renditet i pari. Mandatet për këshillat vendore shpërndahen sipas një sistemi proporcional, ku zbatohet varianti i metodës së mbetjes më të madhe.

Për herë të parë në zgjedhje për organet e qeverisjes vendore, renditja e kandidatëve në listat partiake shumëmemërore mund të ndryshohej pas ditës së zgjedhjeve sipas një formule ri-renditjeje, me kusht që kjo e fundit të ishte paraqitur në Komisionin Zgjedhor të Qeverisjes Vendore (KZQV) përkatës nga ana e partisë politike apo koalicionit në momentin e regjistrimit të listës⁵. Kjo mundësi, që ekzistonte më parë për zgjedhjet për Kuvendin, ishte kritikuar në Raportin Përfundimtar të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005, për shkak se ndikonte mbi transparencën dhe sigurinë në shpërndarjen e mandateve. Kjo dispozitë kufizon

³ Marrëveshja e 12 janarit erdhi pas një takimi më 11 janar midis Kryeministrit Sali Berisha dhe ish Kryeministrit dhe ish Kryetarit të PS-së Fatos Nano, ku të dy mbështetën publikisht marrëveshjen e 29 dhjetorit 2006.

⁴ Në Shqipëri ka 384 NjQV (65 bashki, 308 komuna dhe 11 njësi bashkiake në Bashkinë e Tiranës).

⁵ Në pjesën më të madhe të rasteve, formulat lejoni ri-renditjen e kandidatëve në lista sipas rezultateve zgjedhore të listave partiake në zona apo qendra të caktuara votimi që u caktoheshin kandidatëve në lista para zgjedhjeve dhe ku çdo kandidat duhej të bënte fushatë për partinë.

transparencën, pasi bën që zgjedhësit të mos e dinë se cilët kandidatë ka të ngjarë të zgjidhen nga vendimi i zgjedhësve. Gjithashtu, ajo krijon mundësinë të rrisë numrin e ankimeve dhe apelineve që shqyrtohen nga KQZ-ja dhe Kolegji Zgjedhor.

V. KUADRI LIGJOR

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 18 shkurtit 2007 u zhvilluan sipas një kuadri ligjor të ndryshuar afërsisht një muaj para datës së zgjedhjeve. Kuvendi ndryshoi disa dispozita të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë⁶ dhe Kodit Zgjedhor më 13 janar 2007.

Megjithëse reforma zgjedhore kishte qenë në kalendarin e punimeve të Kuvendit që prej dhjetorit 2005, ajo kishte shënuar pak progres dhe ndryshimet e lartpërmendura ishin, në një masë të madhe, fryt i një marrëveshjeje politike dhe jo një përpjekje për reformë të gjerë zgjedhore. Ndryshimi i legjislacionit zgjedhor dhe shtyrja e zgjedhjeve në një fazë shumë të vonë çoi në domosdoshmërinë për ngjeshje të konsiderueshme të të gjitha afateve ligjore për përgatitjet dhe procedurat zgjedhore. Kjo paraqiti një sfidë të madhe për administratën zgjedhore.

Përgjithësisht, Shqipëria ka një kuadër ligjor adekuat dhe të mjaftueshëm për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Megjithatë, këto zgjedhje treguan, edhe njëherë, se zbatimi i tij varet plotësisht nga vullneti i mirë dhe qasja konstruktive e partive politike, roli dhe përgjegjësia e të cilave në procesin zgjedhor mbeten vendimtare.

Kodi Zgjedhor u jep partive politike të drejtën për të propozuar anëtarë në komisionet zgjedhore të të gjitha niveleve. Në vijim të ndryshimeve të kohëve të fundit, anëtarësia e komisioneve të nivelit të dytë dhe të tretë, si dhe e grupeve të numërimit, u rrit nga shtatë në trembëdhjetë, duke u siguruar përfaqësim gjashtë partive më të mëdha parlamentare të secilit krah të spektrit politik. Anëtari i trembëdhjetë do t'i jepet një prej dy partive kryesore sipas një përzgjedhjeje rastësore (shih më poshtë). Ky ndryshim zvogëlon kontrollin e PS-së dhe PD-së mbi administratën zgjedhore, ndërkohë që ruan qasjen partiake të formimit të organeve të administratës zgjedhore.

Kodi nuk parashikon mekanizma efektivë për plotësimin e vendeve bosh në rast se partitë politike nuk ushtrojnë të drejtën e tyre për të propozuar zyrtarë të zgjedhjeve.⁷ Kjo hapësirë ligjore vjen nga e drejta e partive politike për të zëvendësuar të propozuarit e tyre në administratën zgjedhore në çdo kohë dhe pa arsyetim.

Ndryshimi në nenin 154 të Kushtetutës rriti anëtarësinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nga shtatë në nëntë anëtarë, duke mundësuar përfaqësim më të gjerë politik në KQZ. Megjithatë, neni 22 i Kodit Zgjedhor akoma parashikon se duhen paraqitur “jo më shumë se dy [kandidatura] për çdo vend bosh” nga partitë politike që e gëzojnë këtë të drejtë. Kjo, efektivisht, kufizon të drejtën kushtetuese të Kuvendit të “zgjedhë” këta anëtarë, veçanërisht në rast se paraqitet vetëm një kandidaturë nga partia propozuese. Ky kufizim zbatohet edhe për organe të tjera propozuese, që janë Presidenti i Republikës dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

⁶ Ndryshimi në nenin 109 të Kushtetutës zgjati mandatin e kryetarëve dhe këshillave vendore në katër vjet, dhe ndryshimi në nenin 154 të Kushtetutës rriti anëtarësinë e KQZ-së nga shtatë në nëntë anëtarë.

⁷ Kodi Zgjedhor parashikon që në rast se një parti që e gëzon të drejtën nuk propozon anëtarë të komisionit brenda afatit, e drejta për të propozuar anëtarë ushtrohet nga partia parlamentare e rradhës nga i njëjti krah i spektrit politik. Megjithatë, kjo dispozitë zbatohet rrallë. Më tej, Kodi nuk trajton situatën, kur të gjitha partitë parlamentare të të njëjtit krah të spektrit politik, vendosin të mos propozojnë komisionerë për zgjedhjet, siç ndodhi para marrëveshjes së janarit 2007.

OSBE/ODIHR-i e ka kritikuar këtë më parë pasi, efektivisht, shfuqizon të drejtën kushtetuese të këtyre Institucioneve duke i kthyer ato në organe që miratojnë formalisht.

Ndryshimet e 13 janarit në Kodin Zgjedhor trajtuan disa prej rekomandimeve të mëparshme të OSBE/ODIHR-it. Në veçanti, procedurat e numërimit të votave janë përmirësuar në një shkallë të caktuar. Gjithashtu, afatet për emërimin e grupeve të numërimit u bënë më realiste (dy ditë para ditës së zgjedhjeve në vend të dy orëve para mbylljes së votimit), u parashikua për herë të parë një qasje fleksibël për përcaktimin e numrit të kërkuar të grupeve të numërimit në varësi të përmasës të NjQV-së, dhe u parashikua funksionimi i grupeve të numërimit me turne.

Më tej, disa dispozita të Kodit Zgjedhor në lidhje me ankimet dhe apelimet janë përmirësuar në përputhje me rekomandime të mëparshme të OSBE/ODIHR-it. Ndryshimi i fundit i nenit 146 mundëson KQZ-në të bashkojë, në një procedurë të vetme, kërkesat e mundshme për pavlefshmëri të zgjedhjeve dhe ankimet për të njëjtën qendër votimi apo njësi zgjedhjore, me afate të shkurtuara. Në të shkuarën, ekzistenca e dy procedurave të ndara dhe të njëpasnjëshme çonte në vonesa të konsiderueshme për marrjen e vendimit përfundimtar. Vlerësimi i provave nga KQZ-ja u lehtësua edhe nga një ndryshim në nenet 156 dhe 158 të Kodit Zgjedhor.

Megjithatë, disa prej ndryshimeve të fundit në Kodin Zgjedhor ngrejnë shqetësim. Përveç mundësive të lartpërmendura për të ndryshuar renditjen e kandidatëve në lista pas njohjes së rezultateve, u futën disa procedura të ngarkuara për përdorimin dhe administrimin e certifikatave të lindjes si mjet për identifikimin e zgjedhësve.

Më tej, u parashikuan rregulla kalimtare të posaçme për votimin nga zgjedhësit me të drejtë vote me banim jashtë vendit. Legjislacioni shqiptar nuk e parashikon votimin jashtë vendit. Zgjedhësit me të drejtë vote me banim jashtë vendit mund të votojnë vetëm në njësinë e qeverisjes vendore përkatëse në Shqipëri. Ndryshimet në legjislacion parashikuan se këta zgjedhës do të identifikoheshin, para ditës së zgjedhjeve, në listat e zgjedhësve si 'emigrantë' dhe, për të marrë një fletë votimi, duhej të paraqisnin, veç pasaportës shqiptare, edhe një dokument të dytë lëshuar nga shteti ku banojnë. Kjo dispozitë u kritikua për përfshirje të kërkesave të tepërta për identifikimin e zgjedhësve dhe u interpretua gjerësisht si përpjekje për të kufizuar numrin e zgjedhësve emigrantë. Ky trajtim i pabarabartë i zgjedhësve duhet shmangur në të ardhmen, duke qenë se është diskriminues dhe nuk është në përputhje me paragrafin 7.3 të Dokumentit të OSBE-së Kopenhagë 1990, që garanton të drejta të barabarta të votës.

VI. ADMINSTRATA ZGJEDHORE

A. ORGANET E AMINISTRATËS ZGJEDHORE

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore në Shqipëri administrohen nga një administratë zgjedhore prej tri nivelesh: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), 384 Komisionet Zgjedhore të Qeverisjes Vendore (KZQV) dhe 4 720 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Përveç tyre, Kodi Zgjedhor i ndryshuar parashikon ngritjen deri në 15 Grupe Numërimi (GN) në çdo Njësi të Qeverisjes Vendore për numërimin e votave në 383 Vende të Numërimit të Votave (VNV)⁸.

KQZ-ja është organ i përhershëm kushtetues. Një ndryshim kushtetues i miratuar më 13 janar 2007 e rriti anëtarësinë e KQZ-së nga shtatë në nëntë anëtarë. Të dy anëtarët duhej të zgjidheshin nga Kuvendi me propozim të Partisë Demokratike (PDK) dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim

⁸ Sa i takon Tiranës, në çdo njësi bashkiake u ngrit një VNV, asnjë e tille në nivel të Bashkisë së Tiranës.

(LSI). Nëntë anëtarët e KQZ-së kanë mandat shtatëvjeçar. Partitë politike vazhdojnë të ushtrojnë një ndikim të madh mbi përbërjen e KQZ-së, duke qenë se ato kanë të drejtën të propozojnë kandidaturat për të gjithë anëtarët, që emërohen apo zgjidhen nga Kuvendi (katër anëtarë), Presidenti i Republikës (dy anëtarë) dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (tre anëtarë).

Shumica e kërkuar për miratimin e pjesës më të madhe të vendimeve të KQZ-së është pesë vota dhe mbledhjet e KQZ-së janë të vlefshme nëse janë të pranishëm pesë anëtarë. Megjithatë, nevojitet një shumicë e cilësuar prej gjashtë votash për të shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve, për të marrë vendim për kërkesat ankimore kundër vendimeve të KZQV-së për rezultatin e zgjedhjeve, dhe për të shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendi për listat shumë-emërore. Partitë politike kanë të drejtën të propozojnë përfaqësues në KQZ, që mund të marrin pjesë në diskutime dhe të paraqesin propozime, por që nuk kanë të drejtën e votës.

Ndryshimet në janar 2007 rritën anëtarësinë e KZQV-ve nga 7 në 13 anëtarë, ku gjashtë partitë më të mëdha nga shumica dhe pakica parlamentare kanë të drejtën të propozojnë anëtarë. Duke qenë se kampi i opozitës përbëhet aktualisht nga pesë parti, PS-së, si partia më e madhe e këtij grupi, iu dha e drejta e një anëtari shtesë në çdo KZQV. Dy partitë më të mëdha nga të dy grupet, PD-ja dhe PS-ja, ruajnë të drejtën të propozojnë kryetarët e KZQV-ve dhe anëtarin e trembëdhjetë të çdo KZQV-je në bazë të paritetit, përcaktuar me “përzgjedhje rastësore” dhe “shpërndarje të barabartë territoriale”. Propozimi i anëtarëve të KZQV-ve u vonua ndjeshëm. Sipas ligjit, KZQV-të duhej të ishin ngritur deri më 20 gusht 2006. Formimi i KZQV-ve rinisi efektivisht pas marrëveshjes së janarit 2007. Këto vonesa erdhën për shkak se partitë politike nuk paraqitën në KQZ listat me propozimet e tyre për anëtarësinë e KZQV-ve. Gjithashtu, hedhja e shortit në KQZ, që synonte të përcaktonte se cila parti do të kishte shumicën në çdo KZQV, u pengua për shkak të mungesës së vazhdueshme të përfaqësuesit të PS-së në KQZ. Vonesat në ngritjen e KZQV-ve erdhën edhe si pasojë e disa vështirësive të hasura nga disa prej partive me të drejtë propozimi për të paraqitur propozimet e tyre për të gjitha vendet që u ishin parashikuar nga ndryshimet.

KQV-të dhe GN-të formohen sipas të njëjtave rregulla për KZQV-të. Partitë politike dhe kandidatët e pavarur gëzojnë të drejtën të kenë vëzhgues në KZQV, KQV dhe VNV.

B. VLERËSIM I ORGANIZIMIT TË ZGJEDHJEVE

Pavarësisht nga afatet e ngjeshura ligjore midis datës së hyrjes në fuqi të ndryshimeve dhe datës së zgjedhjeve, si dhe një mjedisi të pasigurtë politik, KQZ-ja e administroi procesin zgjedhor në një masë të madhe në përputhje me ligjin.

Pas rritjes së anëtarësisë së KQZ-së, mungesa e propozimeve nga Partia Demokristiane (PDK) zvarriti zgjedhjen e dy anëtarëve të rinj. Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), partia tjetër që kishte të drejtën për të propozuar një prej anëtarëve shtesë kundërshtoi qëndrimin e Nënkryetarit të Kuvendit. U argumentua se të dyja partitë duhej të paraqesnin nga dy propozime secila për të respektuar të drejtën e Kuvendit për të “zgjedhur” anëtarët e rinj. Anëtarët u zgjedhën më në fund më 6 shkurt 2007. Pavarësisht nga emërimi i vonë i anëtarëve të rinj, KQZ-ja ishte në gjendje, ndërkohë, të vazhdonte të punonte dhe të merte vendime pavarësisht kuorumit të ri (rritur nga 4 në 5) dhe kërkesa për shumicë (rritur nga 4 në 5).⁹

Gjatë periudhës pas marrëveshjes së 12 janarit, KQZ-ja mbajti mbledhje të shpeshta, mori mbi 1 300 vendime dhe miratoi rreth 10 udhëzime që rregullonin procesin zgjedhor. Në pjesën më të madhe, mbledhjet e KQZ-së u zhvilluan në mënyrë profesionale, kolegjinale dhe transparente.

⁹ Shumica e cilësuar u rrit nga 5 në 6 prej 9 anëtarëve.

Propozimeve të partive iu bë përgjithësisht shqyrtim i drejtë. Ndonëse diskutimet ishin disa herë të zgjatura dhe vendimet të vonuara, kjo nuk ndikoi ndjeshëm mbi përgatitjet për zgjedhjet.

Në përgjithësi, personeli i drejtorive të ndryshme të KQZ-së i kreu detyrat në mënyrë të paanshme dhe profesionale. Pëveç personelit në Tiranë, KQZ-ja ngriti 12 Zyra Zgjedhore rajonale, mbështetur nga 36 ndihmës në rrethe që u dhanë KZQV-ve mbështetje teknike dhe logjistike. Ndonëse nuk janë të parashikuara në Kodin Zgjedhor, këto zyra luajtën një rol pozitiv në zgjedhje duke nxitur dërgimin e informacionit në KZQV. Në një numër VNV-shë, roli i tyre ndërmjetës ishte vendimtar në zgjidhjen e çështjeve gjatë numërimit të votave.

Afatet e ngjeshura sollën sfida të vështira logjistike dhe administrative për KQZ-në në lidhje me organizimin e zgjedhjeve. Sipas dispozitave kalimtare të Kodit Zgjedhor, KZQV-të duhej të ishin ngritur deri më 20 janar. I njëjti afat kohor gjente zbatim edhe për regjistrimin e subjekteve zgjedhore pranë KQZ-së, ndërsa afati për regjistrimin e kandidatëve në KZQV ishte 23 janari. KQZ-ja vendosi të shtyjë me një ditë mbledhjen e parë të KZQV-ve, në mënyrë që të lejonte edhe ngritjen e KZQV-ve më të largëta. Afati për regjistrimin e kandidatëve skadoi tri ditë më vonë. Pjesa më e madhe e KZQV-ve u ngritën në fillim me anëtarësi të paplotë pasi jo të gjitha partitë politike i paraqitën propozimet e tyre në kohë.

E drejta e partive për të zëvendësuar anëtarët e tyre në KZQV në çdo kohë krijoi probleme, duke qenë se më shumë se një e treta e anëtarëve të KZQV-ve u zëvendësuan. Këto zëvendësime të shpeshta ndikuan në qëndrueshmërinë e administratës zgjedhore dhe kjo do të thoshte se shumë anëtarë të KZQV-ve që shërbyen gjatë apo pas ditës së zgjedhjeve nuk ishin trajnuar. Zëvendësimet vazhduan deri në ditën para zgjedhjeve pavarësisht nga thirrja e mëparshme e kryetarit të KQZ-së për t'i dhënë fund kësaj praktike.

Gjithashtu, emërimi i vonë i KQV-ve dhe GN-ve reduktoi efikasitetin e administratës, veçanërisht duke marrë parasysh se shumë prej tyre nuk u trajnuan. Disa parti politike i justifikuan veprimet e tyre duke u shprehur se, nëse anëtarët e KQV-ve apo GN-ve do të zbuloheshin kohë para zgjedhjeve, mund të korruptoheshin nga konkurrentët e tyre politikë. Nga ana tjetër, disa parti thane se ato vetë do t'i trajnonin administratorët e zgjedhjeve të propozuar prej tyre. Megjithatë, për shkak të mungesës së trajnimit zyrtar, vëzhguesit dalluan disa raste ku kryetarë të KQV-ve merrnin udhëzime mbi procedurat e votimit nga selitë qendrore të partive përkatëse me anë të telefonit, megjithëse përdorimi i telefonave celularë në KQV dhe VNV ishte ndaluar nga KQZ-ja.

Më tej, disa autoritete të qeverisjes vendore nuk bashkëpunuan plotësisht me KQZ-në. Ato nuk përmbushën afatet ligjore për të paraqitur numrin përfundimtar dhe vendndodhjen e QV-ve nën juridiksionin e tyre, duke i krijuar KQZ-së probleme logjistike të minutës së fundit lidhur me shpërndarjen e duhur të materialeve zgjedhore.

Disa herë, mungesa e kontrollit të plotë nga KQZ-ja mbi komisionerët e niveleve të ulëta të administratës zgjedhore kërcënoi të vinte në rrezik procesin zgjedhor. Me raste, anëtarë të KZQV-ve, KQV-ve dhe GN-ve u duk të ndiqnin udhëzime që vinin nga partitë dhe jo ato që vinin nga hierarkia e administratës zgjedhore. Kjo ishte veçanërisht e dukshme gjatë numërimit, kur deputetë u panë të udhëzonin anëtarët e GN-ve.

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Afatet e ngjeshura kohore të vendosura nga dispozitat kalimtare të Kodit të ndryshuar Zgjedhor në lidhje me ngritjen e KZQV-ve dhe regjistrimin e kandidatëve u provuan të ishin një sfidë si

për KZQV-të edhe për kandidatët. Sipas këtyre dispozitave, kandidatët duhej të regjistroheshin brenda dhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e ndryshimeve, pra, kur KZQV-të sapo ishin ngritur dhe shpesh ishin duke u trajnuar. Me qëllim zgjidhjen e këtij kufizimi kohor, KQZ-ja vendosi t'u japë KZQV-ve edhe 24 orë shtesë për të pranuar dokumentacionin e kandidimit nga kandidatët e mundshëm.

Gjithsej, 1 073 kandidatë për kryetarë, 6 074 kandidatë për këshilltarë në listat e partive apo koalicioneve për këshilla vendore, dhe 212 kandidatë të pavarur për këshilltarë u regjistruan në një proces përgjithësisht përfshirës. Vetëm 33 kandidate për kryetare ishin femra.

Në disa raste, zyrtarë në detyrë që rikandidonin dhe aktivistë partiakë të tjerë që nuk ishin propozuar nga partia e tyre, për shkak të marrëveshjeve politike brenda dy aleancave kryesore, u regjistruan apo u përpoqën të regjistrohen si kandidatë të pavarur. Kandidatët e pavarur që nuk ishin kryetarë në detyrë apo nuk ishin anëtarë të këshillit përkatës vendor apo Kuvendit, duhej të paraqisnin një numër nënshkrimesh mbështetëse nga zgjedhës të regjistruar në listat paraprake të zgjedhësve të NjQV-së përkatëse.¹⁰ Ky numër ndryshon në varësi të numrit të zgjedhësve në NjQV. Në disa raste, regjistrimi i tyre nuk u pranua nga KZQV-ja, që kundërshtoi vërtetësinë e nënshkrimeve mbështetëse të paraqitura.

Procesi i verifikimit të nënshkrimeve mbështetëse ishte i pakënaqshëm. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor nuk specifikuan metodën që KQZ-ja apo KZQV-ja duhej të zbatonin për vlerësimin e nënshkrimeve mbështetëse. Më tej, afatet e ngushta nuk lejuan kohë të mjaftueshme që KZQV-të t'i vlerësonin nënshkrimet sa duhej. Do të kishte qenë i vlefshëm një vendim i KQZ-së për të parashikuar procesin e verifikimit. Disa prej kandidatëve të refuzuar që u ankuan ndaj vendimeve të KZQV-së në KQZ dhe Kolegj Zgjedhor u regjistruan më pas.

Në Tiranë, regjistrimi i z. Akile Rama si kandidat për kryetar bashkie krijoi polemika. Propozimi i z. Akile Rama u paraqit nga Partia Balli Kombëtar Demokrat (PBKD) dhe u pranua nga KZQV-ja e Bashkisë Tiranë, që do ta kishte vendosur në fletën e votimit mbi emrin e kryetarit aktual të bashkisë, dhe kryetar i Partisë Socialiste, z. Edi Rama. Z. Akile Rama, në fillim, deklaroi se nuk ishte në dijeni të propozimit të emrit të tij për kandidat. Më pas, ai kërkoi tërheqjen e kandidaturës së tij për shkak të gjendjes shëndetësore; KZQV-ja pranoi kërkesën e z. Akile Rama dhe e hoqi nga lista e kandidatëve të regjistruar, edhe pse kërkesa e tij për tërheqje u bë pas afatit të parashikuar. Megjithatë, PS-ja bëri një ankesë në Prokurori me pretendimin për falsifikim të nënshkrimeve në këtë rast. Për këtë, u hap një hetim. Ndërkohë, Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i PBKD-së u ndaluan ndërkohë që Sekretari Organizativ u la në arrest shtëpie. Pas disa ditësh, z. A. Rama ndërroi jetë.

VIII. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Në vijim të marrëveshjes politike të 12 janarit 2007, bashkëpunimi midis Zyrate të Gjendjes Civile (ZGjC) në NjQV dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGjC) në Ministrinë e Brendshme (MB) rifilloi në një nivel që lejoi përditësimin e listave të zgjedhësve dhe heqjen e rekordeve të shumëfishta. Lista përfundimtare e zgjedhësve përmbante rreth 2.93 milionë zgjedhës të regjistruar.

Përmirësimet në saktësinë e regjistrave themeltarë të gjendjes civile dhe pëdorimi i *software*-it të posaçëm të përgatitur nga MB-ja duket të kenë çuar në lista më të sakta zgjedhësish në shumë

¹⁰ Kjo gjën zbatim edhe për kandidatët e propozuar nga partitë që nuk janë të përfaqësuara në Kuvend apo këshilla vendorë.

NjQV, krahasuar me zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005. *Software*-i aktual, i përgatitur nga DPGjC-ja, përfshinte një numër komandash kontrolli, përfshirë një regjistruer të dhënash (*log file*) të hollësishëm që regjistronte çdo ndryshim në listat e zgjedhësve.

DPGjC-ja hartoi një plan për asistencë teknike për të gjitha ZGjC-të në mbarë vendin, duke ndërtuar rrjete të brendshme që lejonin shkëmbimin e të dhënave në një mjedis të sigurtë dhe shmangnin krijimin e rekordeve të shumëfishta gjatë hedhjes së të dhënave. ZGjC-të në të gjitha NJQV-të morën manuale trajnimi dhe u trajnuan. Megjithatë, mungesa e një sistemi të duhur adresash, si dhe përfshirja e të dhënave të Regjistrave të Përkohshëm në Regjistrat Themeltarë e ruajtën relativisht të lartë numrin e të ashtuquajturve 'kode të 999' (d.m.th. shtetas pa adresë numerike të plotë), pavarësisht nga një ulje e përgjithshme e këtyre rasteve me rreth 25 për qind. Problemi i 'kodeve 999' u vërejt veçanërisht në zonat urbane. Afatet e ngjeshura ligjore për hartimin e listave të zgjedhësve u shkelën në mënyrë të përsëritur nga një numër NjQV-shë, kryesisht lidhur me dërgimin e listave paraprake të zgjedhësve në DPGjC dhe afishimin e listave paraprake apo përfundimtare të zgjedhësve për t'u verifikuar nga publiku.

Procedurat për zgjidhjen e rekordeve të shumëfishta u përmirësuan. Për këto zgjedhje, DPGjC-ja kontrolloi listat për dublikime të brendshme, të jashtme, dhe ato që vinin nga Regjistrat Themeltarë. Numri i filtrave elektronikë për identifikimin e rekordeve të shumëfishta u dyfishua krahasuar me vitin 2005. Të gjitha këto masa ndihmuan për identifikimin e pjesës më të madhe të këtyre rekordeve të parregullta. Megjithatë, në disa NjQV, vëzhguesit vërejtën se udhëzimet për heqjen e rekordeve të shumëfishta nuk u ndoqën apo u ndoqën pjesërisht nga kryetarët përkatës.

Në pjesën më të madhe të NjQV-ve, identifikimi i zgjedhësve emigrantë, parashikuar nga dispozitat e kalimtare në ndryshimet e 13 janarit 2007, u krye nga grupet përgjegjëse për njoftimin e zgjedhësve. Pati mungesë njëtrajtshmërie në zbatimin e këtyre dispozitave, përfshirë ngritjen e grupeve të identifikimit, përbërjen e tyre dhe mënyrën e punës. Autoritetet e qeverisjes vendore, shpesh, i trajtuan gjetjet e tyre me arbitraritet. Megjithëse vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it, ditën e zgjedhjeve, vërejtën pak probleme me zgjedhësit e identifikuar si emigrantë në listat e zgjedhësve, këto dispozita patën mundësinë për të privuar nga e drejta e votës një numër domethënës shtetasish.

MB-ja publikoi si listat paraprake edhe ato përfundimtare në faqen e saj të internetit, veprim që rriti transparencën e procesit zgjedhor dhe aksesin e shtetasve në të dhënat publike. Në zbatim të ligjit, DPGjC-ja përgatiti kopje elektronike të listave përfundimtare të zgjedhësve për të gjitha partitë politike. Për herë të parë, Ministrisë së Drejtësisë iu dhanë kopje të listave përfundimtare të zgjedhësve për 29 Gjykatat e Shkallës së Parë me qëllim lehtësimin e procesit të verifikimit nga sistemi gjyqësor para dhe gjatë ditës së zgjedhjeve.

Para marrëveshjes politike të 12 janarit 2007, çështja e hartimit të listave të zgjedhësve ishte politizuar shumë dhe referohej vazhdimisht në debatet politike midis shumicës dhe opozitës. Në zbatim të udhëzimeve të partisë së tyre, shumë kryetarë të NjQV-ve nga opozita i penguan ZGjC-të nën varësinë e tyre të dërgonin listat paraprake të zgjedhësve në DPGjC-në e MB-së për kontrollim të rekordeve të shumëfishta. Deri më 12 janar 2007, vetëm 299 nga 384 NjQV kishin dërguar listat paraprake të zgjedhësve në DPGjC. Kjo vonesë e konsiderueshme, që e kishte kaluar afatin fillestar të 22 dhjetorit 2006, pengoi kapacitetin e DPGjC-së për të kryer një kontroll në rang vendi për rekorde të mundshme të shumëfishta.

Si pjesë e marrëveshjes së 12 janarit 2007, dispozita kalimtare për hartimin e listave të zgjedhësve parashikoi afate të ngjeshura, përfshirë edhe ato për kontrollin e rekordeve të shumëfishta. Pavarësisht nga këto rrethana sfiduese, DPGjC-ja dhe ZGjC-të, përgjithësisht, ishin

në gjendje për të ndrequr, shtypur dhe afishuar listat e zgjedhësve brenda afateve ligjore. Pas marrëveshjes së janarit 2007, NjQV-të, në përgjithësi, provuan të ishin më bashkëpunuese me autoritetet qendrore.

Pavarësisht nga papërsosmëritë në proces dhe mangësitë që mbeten për t'u trajtuar, përpjekjet për përmirësimin e listave të zgjedhësve kanë qenë shumë domethënëse dhe, në një shkallë të madhe, të suksesshme. Megjithatë, mungesa e një sistemi plotësisht funksional të gjendjes civile, adresave dhe kartave të identifikimit personal e zvogëloi disi rezultatin e këtyre përpjekjeve.

IX. CERTIFIKATAT E LINDJES

Sipas Kodit Zgjedhor, certifikatat e lindjes me fotografi të mbajtësit janë një formë e mundshme e identifikimit të zgjedhësit, dhe certifikatat përdoren gjerësisht në Shqipëri si mjet për vërtetimin e identitetit të personit. Ato lëshohen nga ZGjC-të në nivel vendor dhe në Shqipëri ka mbi 400 të tilla.

Në Raportin e vet Përfundimtar për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005, OSBE/ODIHR-i rekomandoi se autoritetet qendrore duhet të sigurojnë që ZGjC-të të regjistrojnë certifikatat e lëshuara për të gjitha qëllimet, në veçanti për qëllime zgjedhore, dhe se këto të dhëna duhet të jenë publike. Ky rekomandim u zbatua, megjithëse i vonuar, kur Ministria e Brendshme nxori Urdhërin Nr. 2656 datë 1 nëntor 2006, që parashikon regjistrimin e hollësishëm të të gjitha certifikatave të lëshuara nga punonjësit e ZGJC-ve në nivel vendor në një Regjistër të Posaçëm. Megjithatë, duket se jo të gjitha ZGjC-të e zbatuan këtë urdhër në kohën e parashikuar. Në vitin 2006, doli një model i ri i certifikatës me elemente shtesë sigurie dhe certifikatat e reja të paplotësuara u shpërndanë në NjQV duke filluar nga gushti 2006, megjithëse jo të gjitha NjQV-të i morën ato në atë kohë. Në disa vende, certifikatat e reja filluan t'u lëshohen shtetasve vetëm në tetor 2006.

Certifikatat e lindjes u bënë çështje e një polemike të thellë midis Qeverisë dhe opozitës gjatë muajve para zgjedhjeve, ku partitë nga të dy krahët nuk binin dakord për faktin nëse zgjedhësve u duhej dhënë mundësia të përdornin certifikata të lëshuara para se të bëhej i detyrueshëm regjistrimi i tyre në Regjistrin e Posaçëm. Më 29 dhjetor 2006, u arrit një marrëveshje mes PS-së dhe PD-së, por ajo u kundërshtua nga PS-ja të nesërmen. Faktikisht, çështja u zgjidh si pjesë e marrëveshjes së 12 janarit 2007.

Në disa NjQV, kryetarët e kushtëzuan lëshimin e certifikatave me pagesën e taksave vendore (p.sh në Vlorë). Më 23 janar, MB-ja nxori një 'kujtesë' që rishprehte dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe akteve të tjera ligjore për zbatimin e kuadrit përkatës ligjor nga ana e ZGjC-ve. Kjo 'kujtesë' ishte subjekt i polemikave midis Qeverisë dhe opozitës, ku PS-ja pretendonte se 'kujtesa' lehtësonte efektivisht lëshimin e certifikatave të lindjes për shtetas që nuk paraqisnin ndonjë provë për identitetin e tyre. PD-ja, nga ana e vet, pretendonte se punonjësit e ZGjC-ve në NjQV-të e kontrolluara nga PS-ja u kërkonin shtetasve, që besohej të ishin mbështetës të PD-së, dokumentacion mbështetës të paarsyeshëm.

Ngritja e grupeve dyshe të emëruara nga Prefekti dhe partia kryesore e opozitës në nivel NjQV-je për monitorimin e punës së ZGjC-ve provoi, gjithashtu, të ishte çështje polemike. Në Tiranë, disa kryetarë të njësive bashkiake refuzuan praninë e këtyre grupeve në ZGjC-të nën juridiksionin e tyre me argumentin se ligji parashikon praninë e këtyre grupeve vetëm në nivel bashkie dhe jo në nivel njësive bashkiake. Megjithatë, në Tiranë, certifikatat e lindjes për qëllime zgjedhore lëshohen vetëm nga ZGjC-të e njësive bashkiake. Duket se ndryshimet në Kodin

Zgjedhor nuk morën parasysh ndarjen e veçantë territoriale-administrative të Bashkisë së Tiranës.

X. FUSHATA ZGJEDHORE

Gjatë gjithë periudhës zgjedhore të vëzhguar, fushata u karakterizua nga përfshirja aktive e partive politike dhe kandidatëve të pavarur. Megjithëse mjedisi i përgjithshëm i fushatës mbeti i qetë përgjithësisht, fushata rajonale ishte disa herë e ngarkuar me tension dhe në disa raste vëzhguesit vërejtën incidente të dhunshme.

Në vijim të dekretit të Presidentit më 14 janar 2007, që ricaktoi datën e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore për më 18 shkurt 2007, fushata zgjedhore nisi me një start të shpejtë e të dukshëm në mbarë vendin, ku të dyja partitë më të mëdha krijuan aleanca të partive politike në secilin krah të spektrit politik.¹¹ Të dyja aleancat propozuan kandidatë të përbashkët për kryetarë bashkie dhe komune, por kandiduan me lista partiake të vecanta për këshillat vendorë; asnjëri krah nuk u regjistrua si koalicion formal. Fushata u karakterizua nga një numër i qenësishëm kandidatësh që u shkëputën nga rradhët e partisë së tyre me qëllim kandidimin si kandidatë 'të pavarur' kundër ish-partnerëve të tyre. Gjithashtu, pati të dhëna se, në raste të caktuara, si nga e Majta edhe nga e Djathta u ushtrua trysni mbi këta kandidatë të pavarur për t'u tërhequr me qëllim mosndarjen e votës.

Bashkëbiseduesit vunë re disa probleme në lidhje me mundësinë për fushatë dhe fushata e dukshme ishte mbizotëruese në mbarë vendin. Pjesa më e madhe e veprimtarive u zhvillua në kuadrin e dy aleancave dhe përfshinte koncerte, mitingje, takime publike, dhe fushatë derë më derë. Fushata u karakterizua, gjithashtu, nga një përfshirje e nivelit të lartë të lidhshimit qendror të partive në fushatat vendore, ku udhëheqësit e partive nga secili krah udhëtuan në zona të ndryshme të vendit në mbështetje të kandidatëve të aleancës së tyre.

U vërejtën disa incidente të grisjes të posterave nga kundërshtarët dhe disa raste të pakta kaluan në dhunë. Gjatë një rasti të tillë në Gjirokastrë, u nxorën thika dhe një armë zjarri. Në Tiranë, nga aktivistë të PD-së u pretendua se ishin rrahur nga një deputet i PS-së.

Me përjashtim të disa sulmeve negative dhe shumë të personalizuara në fillim të fushatës zgjedhore, toni i veprimtarive u bë më konstruktiv gjatë ecurisë së fushatës. Çështja e sulmeve të personalizuara u ngrit edhe nga gjashtë OJF të ngarkuara nga Presidenti Moisiu për monitorimin e respektimit nga partitë të Kodit të Sjelljes, sugjeruar prej tij më 19 janar 2007. Megjithëse mesazhet në mitingjet e fushatës u përqendruan kryesisht në kritika nga secila palë kundër tjetrës, ato përfshinin edhe disa propozime praktike programatike. Raste të retorikës së ashpër të fushatës mbetën të rralla.

Afër ditës së zgjedhjeve, u ngritën pretendime të shumta për keqpërdorimin e burimeve shtetërore. Në Korçë, një punonjës i një qendre të kujdesit shëndetësor u pushua pa paralajmërim. Personi pretendoi se pushimi erdhi, pasi ishte aktivist i PS-së në një administratë të PD-së. Ky person u ankua në gjykatë për shkarkimin e tij. Po ashtu, çështja e financimit të fushatës u ngrit publikisht në një numër rastesh. Megjithëse Kodi Zgjedhor kërkon vetëm kthimin nga subjektet politike, në KQZ, pas zgjedhjeve, të fondeve të pashpenzuara, nuk ka asnjë detyrim ligjor që këto fonde të bëhen publike. Mund të merret në konsideratë fakti nëse

¹¹ Partitë e shumicës parlamentare u grupuan në një aleancë nëntë-partiake, që përfshinte gjashtë parti parlamentare dhe tri parti jashtë Kuvendit. Gjithsesi, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut ndoqi një strategji për lidhje të aleancave në nivel vendor. Opozita parlamentare u grupua në një aleancë pesë-partiake.

publikimi i tyre mund të nxisë transparencën financiare të fushatave politike, duke rritur, kështu, besimin në proces.

XI. MEDIA

A. KUADRI RREGULLUES

Nenet 133–142 të Kodit Zgjedhor parashikojnë bazën kryesore ligjore për zhvillimin e fushatës zgjedhore në media. Jashtë periudhave zyrtare të fushatës, veprimtaria e medias elektronike rregullohet nga Ligji “Për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat”, që i detyron mediat elektronike “t’i paraqesin faktet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme”.

Kodi Zgjedhor parashikon kufizime të tjera për median elektronike gjatë një fushate zgjedhore, në lidhje me pasqyrimin në lajme, minutazhin falas (në operatorët publikë) dhe publicitetin me pagesë (në operatorët privatë). Gjithashtu, Kodi parashikon qartë sanksione për raste të moszbatimit të këtyre rregullave.

Në edicionet e lajmeve, mediave elektronike u kërkohet t’i japin çdo partie ‘të madhe’¹² dyfishin e kohës së secilës parti ‘të vogël’¹³, ndërsa minutazhi i çdo partie joparlamentare nuk duhet të jetë më i madh se minutazhi për një parti parlamentare. Një qasje e përafërt gjen zbatim edhe për minutazhin falas në radio-televizionin publik. Gjithashtu, partitë ‘e mëdha’ kanë të drejtën të blejnë nga operatorët privatë minutazh për publicitet me pagesë sa dyfishi i minutazhit të partive ‘të vogla’.

Televizioni publik shqiptar (TVSH) i përmbushi detyrimet e tij për minutazh falas për të gjitha partitë e regjistruara për këto zgjedhje. Megjithatë, partitë treguan interes të kufizuar në shfrytëzimin e kësaj mundësie. Në TVSH, u transmetuan rregullisht debate midis kandidatëve kryesorë për kryetarë në qytetet kryesore, duke u siguruar këtyre kandidatëve një forum publik dhe zgjedhësve një mundësi për të marrë informacion. Megjithatë, një debat i planifikuar midis dy kandidatëve kryesorë për Kryetar të Bashkisë së Tiranës nuk u zhvillua.

Respektimi i dispozitave të Kodit Zgjedhor për median mbikqyret nga Bordi i Monitorimit të Medias (BMM), një organ këshillimor i ngritur nga KQZ-ja. Gjatë fushatës zgjedhore, mbështetur në konstatimet e BMM-së, KQZ-ja urdhëroi operatorët kryesorë televizive, përfshirë TVSH-në, të “korrigjojnë pabarazinë” në pasqyrim në favor të dy partive kryesore. Gjithsesi, megjithëse konstatimet e BMM-së treguan se partitë ‘e vogla’ morën më pak minutazh se sa u takonte, BMM-ja nuk i përdori kompetencat e veta për të propozuar edhe kompensimin e këtyre partive. KQZ-ja hodhi poshtë dy kërkesa për kompensim nga parti të vogla, Partia Aleanca Demokratike (PAD) dhe Partia Social Demokrate (PSD)

Ndonëse BMM-ja, në përgjithësi, e përmbushi mandatin e vet dhe e ndihmoi KQZ-në në identifikimin e shkeljeve të Kodit Zgjedhor nga media, një numër mangësishë, përfshirë fillimin me vonesë të veprimtarive të monitorimit dhe pamjaftueshmërinë teknike, ndikuan negativisht mbi veprimtaritë e saj.

¹² Partitë ‘e mëdha’ janë partitë që kanë fituar më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend në zgjedhjet më të fundit për Kuvendin. Aktualisht, këto janë Partia Demokratike dhe Partia Socialiste.

¹³ Partitë ‘e vogla’ janë partitë që kanë fituar deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend në zgjedhjet më të fundit për Kuvendin.

B. MONITORIMI I MEDIAS NGA MVZ-JA E OSBE/ODIHR-IT

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it monitoroi mediat kryesore elektronike dhe të shtypura¹⁴ në periudhën nga 13 dhjetor 2006 deri më 18 janar 2007 (para periudhës zyrtare të fushatës) dhe që prej 19 janarit e deri në 16 shkurt 2007 (gjatë periudhës zyrtare të fushatës).

Fushata në media u duk të përqendrohej në pesonalitete dhe jo në platforma politike, ku dy partitë kryesore zunë pjesën më të madhe të minutazhit. Megjithëse media e rriti paksa minutazhin për partitë e vogla gjatë periudhës zyrtare të fushatës, përgjithësisht, dy partitë kryesore politike vazhduan të mbizotëronin. Megjithëse media elektronike favorizonte qartë parti të caktuara para fillimit të fushatës, edicionet kryesore të lajmeve u bënë më të balancuara me fillimin e periudhës zyrtare të fushatës.

Para periudhës zyrtare të fushatës, operatori publik, TVSH-ja, i dha PD-së 32 për qind të minutazhit politik në lajmet kryesore, kryesisht në ton pozitiv dhe neutral, ndërsa PS-ja mori 23 për qind, me shkallë përafërsisht të njëjtë informacioni pozitiv dhe negativ. Gjatë periudhës së fushatës, operatori publik i pasqyroj të dyja partitë në mënyrë të barabartë, duke i dhënë 28 për qind PD-së dhe 29 për qind PS-së.

Prirje të ngjashme u vunë re në operatorët privatë Vizion + dhe News24, ku PS-ja mori në mënyrë të konsiderueshme më shumë kohë se PD-ja para fillimit të fushatës, por minutazhi u bë më i barazpeshuar gjatë periudhës së fushatës. Një tjetër televizion privat, TV Arbëria, u dha partive kryesore politike pak a shumë të njëjtën shkallë pasqyrimi pozitiv dhe neutral, si para edhe gjatë periudhës së fushatës, por ndryshe nga operatorë të tjerë, i dha më shumë kohë partive të tjera, në veçanti LSI-së. Para fillimit të periudhës zyrtare të fushatës, televizioni privat, TV Klan, i dha PS-së 29 për qind të minutazhit me pasqyrim në pjesën më të madhe neutral dhe negativ, krahasuar me 19 për qind me pasqyrim kryesisht neutral për PD-në. TV Klan i kushtoi më shumë kohë Qeverisë (27 për qind) se çdo operator tjetër i monitoruar nga MVZ-ja. Kjo qasje nuk ndryshoi ndjeshëm gjatë periudhës zyrtare të fushatës dhe operatori vazhdoi të paraqesë zyrtarët e shtetit si përfaqësues të qeverisë, edhe kur ata merrnin pjesë në veprimtari të fushatës.

Megjithëse Kodi Zgjedhor i jep të drejtë secilës parti ‘të madhe’ të blejë dy herë më shumë minutazh me pagesë se secila parti ‘e vogël’, dispozitat përkatëse ligjore nuk u respektuan. Konstatimet e monitorimit nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it tregojnë se nga operatorët e monitoruar, dy partitë kryesore politike blenë më shumë se 65 për qind, dhe në disa raste deri në 80 për qind të të gjithë publicitetit politik. As barazpesha midis dy partive kryesore nuk u ruajt dhe publiciteti për PD-në ishte ndjeshëm mbizotërues në TV Klan, Top Channel dhe Vizion +.

Media e shtypur pasqyroj gjerësisht çështjet zgjedhore dhe paraqiti një gamë të gjerë pikpamjesh. Megjithatë, dy partitë e mëdha mbizotëruan pasqyrimin.

Monitorimi i medias nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it tregoi se një numër mediash shkelën heshtjen zgjedhore ditën para zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve duke botuar artikuj politikë dhe intervista me kandidatë të ndryshëm.

¹⁴ Televizione: TVSH (publik), TV Klan (privat, liçencë kombëtare), TV Arbëria; (privat, liçencë kombëtare), Top Channel (privat, liçencë rajonale), Vizion + (privat, liçencë rajonale) dhe News24 (privat, liçencë rajonale), Gazeta: Gazeta Shqiptare, Shekulli dhe Shqip.

XII. Pjesëmarrja e Pakicave Kombëtare

Ka një mungesë të vazhdueshme të të dhënave zyrtare të besueshme për pakicat në Shqipëri¹⁵. Megjithatë, pranohet gjerësisht se grupimi më i madh i pakicave është pakica greke. Përveç tyre, në Shqipëri jetojnë edhe bashkësi bullgare, maqedonase, malazeze, rome, serbe dhe vllehe.¹⁶

Një numër çështjesh të lidhura me zgjedhjet u ngritën brenda bashkësisë rome në këto zgjedhje. Në bashkësi rome, pati pretendime për blerje të votës nga kandidatë; një rast, ku përfshihej një kandidat i PD-së në Pogradec, u vërtetua. Probleme specifike u vërejtën me përfshirjen e romëve në listat e zgjedhësve. Kjo është një çështje që është theksuar gjatë zgjedhjeve të mëparshme dhe, në përvijimin e regjstrit të ri kombëtar të gjendjes civile, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar përfshirjes së këtyre grupimeve të pakicave kombëtare të privuara nga e drejta e votës.

KQZ-ja konfirmoi se, ndonëse fletët e votimit u printuan vetëm në shqip, ajo prodhoi materiale për edukimin e zgjedhësve dhe spote radiofonike në gjuhët greke, maqedonase dhe serbo-malazeze. Megjithatë, ajo nuk ishte në gjendje të siguronte të dhëna të ndara sipas pakicave kombëtare për anëtarë të komisioneve zgjedhore apo kandidatë të regjistruar, pasi këto të dhëna nuk regjistroheshin.

Gjithashtu, vlen të vihet në dukje se, në komunën Liqenas (Qarku Korçë), partia Aleanca Maqedonase për të Ardhmen Evropiane (PMAE), e krijuar së fundmi, arriti të zgjedhë një prej anëtarëve të saj si kryetar komune. Kjo dha një shembull të mirë për efektshmërinë e mobilizimit politik të pakicave.

XIII. Pjesëmarrja e Grave

Ndonëse kushtetuta shqiptare siguron barazi gjinore, gratë mbeten vazhdimisht të nënpërfaqësuar në jetën publike shqiptare, ku rrallë marrin poste të larta politike. Nga 140 deputetë në Kuvend, vetëm 10 janë gra, vetëm një nga 16 postet ministrore mbahet nga një grua, dhe asnjë nga partitë parlamentare nuk kryesohet nga një grua. Më tej, në këto zgjedhje vendore, vetëm 33 nga 1 073 kandidatët e propozuar për poste të kryetarëve të NjQV-ve ishin gra (3 për qind).

Për të fuqizuar pjesëmarrjen e grave, janë ndërmarrë nisma të ndryshme nga OJF-të dhe, në vite të mëparshme, edhe nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, si dhe nga organizata të tjera të Bashkësisë Ndërkombëtare në vend në mbështetje të një pjesëmarrjeje më të madhe të grave në procese politike dhe zgjedhore. Një OJF vendase, Koalicioni për Pjesëmarrjen e Grave dhe të Rinjve në Politikë, i ka bërë kërkesë Kuvendit për futjen e kuotës prej 30 për qind për deputete femra. Në të njëjtën kohë, ata i kanë kërkuar dhe kanë marrë mbështetje nga Zyra e Avokatit të Popullit për përpjekjen e tyre. Megjithatë, nuk është e qartë se deri në çfarë mase do të merret parasysh nisma e tyre në procesin e pritshëm të reformës së mëtejshme zgjedhore.

Shumica e partive politike i trajtojnë çështjet e grave në programet e tyre politike dhe disa prej tyre organizuan veprimtari të ndryshme që synonin specifikisht zgjedhëset femra gjatë fushatës

¹⁵ Megjithëse Instituti shqiptar i Statistikave (INSTAT) harton informacione mbi grupet e pakicave kombëtare dhe Ministria shqiptare e Punëve të Jashtme dërgon raporte në Komitetin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut si dhe në Këshillin e Evropës, regjistrimi i fundit kombëtar i popullsisë që trajtoi çështjen e identifikimit të pakicave kombëtare ishte në vitin 1989 (gjatë këtij regjistrimi, 2 për qind e popullsisë u identifikua si pakicë kombëtare). Këto shifra konsiderohen në masë të gjerë si të vjetëruara dhe jo më përfaqësuese.

¹⁶ Jo të gjitha këto grupe etnike njihen si pakica kombëtare nga Qeveria Shqiptare. Megjithatë, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, lidhja me një grup pakice mbështetet mbi vetë-identifikimin.

zgjedhore. Gjithashtu, disa parti paraqitën kuota të brendshme paktiake për këto zgjedhje; në rastin e PS-së deri në 50 për qind. Megjithatë, zbatimi i formulave të partive politike për rirënditje pas ditës së zgjedhjeve zvogëloi çdo efekt të mundshëm përfitues të këtyre kuotave në këto zgjedhje.

Votimi familjar vijoi të ishte një çështje shqetësuese në këto zgjedhje dhe vëzhguesit e MNVZ-së e vërejtën këtë problem në 30 për qind të qendrave të votimit të vizituara në ditën e zgjedhjeve. Kjo praktikë vazhdon të ngrejë shqetësim serioz për privimin nga e drejta e votës e disa grave dhe anëtarëve të tjerë të familjes të prekur nga kjo dukuri. Përpjekje të mëtejshme për edukimin e zgjedhësve dhe trajnimin e komisionerëve të zgjedhjeve për këtë çështje mund ta zvogëlojnë këtë problem në të ardhmen.

XIV. VËZHguesIT VENDAS JOPARTIAKË

Sipas nenit 18 të Kodit Zgjedhor, organizata jofitimprurëse shqiptare (OJF) gëzojnë të drejtën të dërgojnë vëzhgues në zgjedhje. Si e tillë, kjo dispozitë përmbush një Angazhim të rëndësishëm të OSBE-së në dokumentin e Kopenhagës 1990; konkretisht paragrafin 8. Në përgjithësi, KQZ-ja përdori një qasje të hapur e transparente për akreditimin e vëzhguesve.

Gjithsej, nga KQZ-ja u akredituan 3 729 vëzhgues vendas për këto zgjedhje vendore. Nisma më e madhe e shoqërisë civile u organizua nga një koalicion i OJF-ve vendase, që përfshinte shtatë grupe vendase që dërguan mbi 3 200 vëzhgues vendas në mbarë vendin.

Gjithashtu, OJF-të “Mjaft!” dhe “Elections to Conduct Agency” (ECA) organizuan një pasqyrim paralel të rezultateve (PPR) dhe i publikuan rezultatet në faqen e internetit të ECA-s. Në mungesë të një faqeje interneti funksionale të KQZ-së natën e zgjedhjeve dhe të rezultateve paraprake në kohë, ky veprim rriti transparencën.

XV. ANKIMET DHE APELIMET PARAZGJEDHORE

Kodi Zgjedhor parashikon procedurat për trajtimin e vetëm disa lloj mosmarrëveshjeve zgjedhore. Konkretisht, ai rregullon ankimin ndaj vendimeve të KZQV-ve (apo ndaj mosmarrjes së një vendimi nga ana e KZQV-ve) në KQZ si dhe apelimin ndaj vendimeve të KQZ-së në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë. Regjistri i ankimeve në KQZ kufizohet vetëm në kategorinë e lartpërmendur. Sipas këtij regjistri, KQZ-ja shqyrtoi 56 kërkesa ankimore para ditës së zgjedhjeve. Nga këto, 14 u pranuan dhe çuan në rrëzimin e vendimeve të KZQV-ve. Si rrjedhojë, KQZ-ja urdhëroi KZQV-të të regjistrojnë pesë kandidatë për kryetarë dhe pesë lista shumemërore për kandidatë për këshilltarë. Më tej, 18 kërkesa ankimore u hodhën poshtë si të pabazuara; të tjerat u pushuan.

Pjesa më e madhe e mosmarrëveshjeve parazgjedhore u nxitën nga polemikat lidhur me regjistrimin e kandidatëve nga KZQV-të. Në shumë raste, mospranimet e kundërshtuara të kandidaturave ishin të mbështetura mbi mangësitë në listat e nënshkrimeve mbështetëse të paraqitura sipas nenit 81 të Kodit Zgjedhor. Duke patur parasysh mungesën e një udhëzimi ose directive në nivel qendror mbi metodat dhe kriteret për verifikimin nga KZQV-të të nënshkrimeve mbështetëse, vlerësimi i bërë nga KQZ-ja për besueshmërinë e këtyre dokumenteve ishte, disa herë, i diskutueshëm. Kështu, nga tetë apeline të paraqitura në Kolegjin Zgjedhor nga kandidatë të mospranuar apo të çregjistruar, katër u pranuan.

Gjithsej, gjatë periudhës parazgjedhore, 17 vendime të KQZ-së u apeluar në Kolegjin Zgjedhor, nga të cilat shtatë u hodhën poshtë. Si KQZ-ja edhe Kolegji Zgjedhor i shqyrtuan kërkesat ankimore parazgjedhore në mënyrë transparente dhe profesionale dhe, në përgjithësi, i respektuan afatet ligjore për marrjen e vendimeve.

Pati disa raste kur kandidatë të pavarur për këshillat vendore humbën statusin e kandidimit të tyre për shkak të gabimeve teknike apo administrative nga ana e administratës zgjedhore dhe, duke mos qenë në dijeni për këtë, humbën afatet për të kërkuar zgjidhje ligjore.

XVI. VOTIMI DHE NUMËRIMI

A. VOTIMI

Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë dhe zgjedhjet u administruan në mënyrë profesionale në pjesën më të madhe të Qendrave të Votimit të vizituara nga vëzhguesit. Megjithatë, kjo tablo e përgjithshme pozitive u eklipsua nga mangësi proceduriale dhe, në disa NjQV, nga tension.

Shumë QV, ku u vëzhgua hapja, u hapën me vonesa të konsiderueshme. Kjo u duk se erdhi kryesisht për shkak të dërgesës me vonesë apo të paplotë të materialeve zgjedhore, apo të emërimit me vonesë të anëtarëve të KQV-ve, disa prej të cilëve nuk ishin propozuar deri në mbrëmjen para zgjedhjeve. Rreth 75 QV nuk u hapën fare. Në Tiranë, në Njësinë Bashkiake 1, kryetari ndryshoi numërtimin e QV-ve pas afatit ligjor; si pasojë, KQV-të morën lista zgjedhësish dhe fletë votimi të parashikuara për KQV të tjera.

Në përgjithësi, vëzhguesit e MNVZ-së e karakterizuan procesin e votimit si 'keq' apo 'shumë keq' në 10 për qind të QV-ve të vizituara. Ankime formale u paraqitën nga subjekte zgjedhore në 6 për qind të QV-ve të vizituara.

Disa probleme të vëzhguara, veçanërisht ato të lidhura me identifikimin e zgjedhësve, rrodhën nga zbatimi i marrëveshjes së 12 janarit. Në një masë domethënëse prej 13 për qind të QV-ve të vizituara, KQV-ve nuk u ishin dërguar kopje të Regjistrit të Posacëm të certifikatave të lindjes. Kjo u duk të ishte kryesisht për shkak të pasigurisë nëse do të ishin KZQV-të apo NjQV-të përgjegjëse për t'ua dërguar ato. Në disa QV, mungesa e këtyre kopjeve pengoi procesin e votimit. Në ato QV ku ishin dërguar kopje të Regjistrit të Posacëm, disa herë, KQV-të nuk i përdorën, si për shembull, në rastin e Njësisë Bashkiake 7 në Tiranë, dhe bashkitë Kamëz, Gjirokastrë, Berat dhe Poliçan. Në 20 për qind të QV-ve të vizituara, certifikatat e lindjes nuk u verifikuan me Regjistrin e Posacëm dhe në 29 për qind, certifikatat nuk u mbajtën nga KQV-të. Ndonëse procedurat për verifikimin e certifikatave me kopje të Regjistrit të Posacëm mund të kenë qenë tejet të mbingarkuara dhe të vështira për t'u zbatuar në praktikë, mungesa e shpeshtë e këtyre verifikimeve përbëri shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe hoqi një element të rëndësishëm sigurie kundër votimit të shumëfishtë dhe përvetësimit të identitetit të shtetasve të tjerë.

Në 34 për qind të QV-ve të vëzhguara, zgjedhësit u kthyen mbrapsht pasi emrat e tyre nuk gjendeshin në listat e zgjedhësve. Megjithatë, numri i këtyre personave ishte i ulët në shumicën dërrmuese të këtyre rasteve. Personat e shënuar si emigrantë në listat e zgjedhësve, përgjithësisht, u duk se nuk hasën pengesa artificiale për të votuar, megjithëse disa mund të jenë privuar nga e drejta e votës.

Boja e dukshme e përdorur për të shenjuar zgjedhësit ishte në qendër të polemikave për shkak të pretendimeve se mund të fshihej lehtë. Ditën e zgjedhjeve, PS-ja bëri kallzim kundër kryetarit të

KQZ-së lidhur me cilësinë e bojës, dhe kampionë boje të përzgjedhur rastësisht u konfiskuan nga prokuroria në një numër QV-shë. Megjithatë, polemika mbi cilësinë e bojës u shua shpejt pas ditës së zgjedhjeve. Pavarësisht nga problemet e pretenduara për cilësinë e bojës, u ngritën shqetësime për përdorimin e saj në praktikë: vëzhguesit e MNVZ-së raportuan se në 20 për qind të QV-ve të vizituara, zgjedhësit u kontrolluan rrallë ose aspak për gjurmë të bojës dhe në 11 për qind, boja u përdor rrallë ose aspak.

Vëzhguesit raportuan tension apo trazirë në 7 për qind të QV-ve të vizituara si dhe raste të izoluara dhune. Persona të paautorizuar ndërhyjnë në proces në 4 për qind të QV-ve të vizituara. Gjithashtu, në 4 për qind të QV-ve të vizituara, persona u përpoqen të ndikonin mbi zgjedhësit. Raste të trysnisë mbi zgjedhësit u raportuan nga pak NjQV; për shembull, Bushat dhe Gruemirë, të dyja në Qarkun Shkodër. Në një QV në Bushat, katër anëtarë të KQV-së nga partitë e shumicës u larguan dhe nuk u zëvendësuan pasi mbështetësit e Partisë Demokristiane 'kërkuan' të drejtën për t'i zëvendësuar.

Votimi në grup u vëzhgua në një masë të lartë prej 31 për qind të QV-ve; kjo nënvizon nevojën e vazhdueshme për edukim të zgjedhësve dhe trajnim të komisionerëve zgjedhore. U raportuan, gjithashtu, raste të izoluara të votimit për të tjerë apo atij të shumëfishtë. Më tej, vëzhguesit vërejtën shkelje të tjera te pakta, por serioze. Në një QV në Poshnjë, një anëtar i KQV-së po nënshkruante në listën e zgjedhësve, kur aty nuk kishte asnjë zgjedhës te pranishëm. Në Himarë, një KQV u duk t'i bënte qëllimisht të pavlefshme fletët e votimit duke ua dhënë ato zgjedhësve me gjithë kundërfletën, duke i firmosur, apo duke mos i vulosur si duhet. Vëzhguesit e raportuan procesin si problematik në QV të tjera në Himarë.

Në Tiranë, u përdoren fletë votimi me ngjyra përfaqësisht të ngjashme për votime të ndryshme. Kjo çoi në pështjellim dhe mund të ketë sjellë një numër të konsiderueshëm fletësh votimi të hedhura në kutinë e gabuar të votimit dhe duke i bërë kështu të pavlefshme.

Vëzhguesit e partive apo kandidatëve ishin të pranishëm në 75 për qind të QV-ve të vizituara; vëzhguesit vendas jopartiakë, kryesisht nga 'Koalicioni i OJF-ve Vendase' u identifikuan në 33 për qind të QV-ve. Vëzhguesit i përshkruan shumë mjedise të QV-ve si tepër të vogla e të papërshtatshme. Ndonëse kjo ishte shpesh për shkak të kufizimeve infrastrukturore, numri i lartë i anëtarëve të KQV-ve kontribuoi më tej në këtë problem. Aksesit në 12 për qind të QV-ve të vizituara u konsiderua i vështirë, gjë, që mund të ketë ndikuar në votimin nga ana e zgjedhësve me aftësi të kufizuar dhe atyre të moshuar.

Në disa NjQV, situata degradoi gjatë pasdites së ditës së zgjedhjeve. Në disa njësi bashkiake të Tiranës, zgjedhës të shumtë dhe njerëz të tjerë u grumbulluan jashtë disa QV-ve, u raportua tension, dhe disa QV u mbyllën me vonesa të konsiderueshme dhe në rrethana kaotike, ku zgjedhës, që ishin duke pritur jashtë, nuk u lejuan të votojnë.

Në vende të tjera, QV-të përgjithësisht u mbyllën në kohë, dhe pjesa më e madhe e vëzhguesve raportoi se zgjedhësit që prisnin në rradhë u lejuan të votojnë, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Procedurat e mbylljes u respektuan në një shkallë të madhe. Megjithatë, kopje e procesverbalit të mbylljes nuk iu dha gjithmonë atyre që kishin të drejtën për ta marrë, konkretisht, anëtarëve e KQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare. Gjithashtu, disa vëzhgues raportuan praninë e personave të paautorizuar gjatë mbylljes.

Vëzhguesit e MNVZ-së bënë vizita në ZGjC menjëherë para ose në ditën e zgjedhjeve për të vëzhguar lëshimin e certifikatave të lindjes. Pjesa më e madhe e ZGjC-ve të vizituara nga vëzhguesit e MNVZ-së menjëherë para dhe në ditën e zgjedhjeve ishin të hapura dhe në 49 për qind të tyre kishte rradhë me qytetarë që prisnin për t'u pajisur me certifikatë lindjeje.

Vëzhguesit e MNVZ-së vërejtën mungesë njëtrajtshmërie në lidhje me orarin e hapjes dhe mbylljes së ZGjC-ve ditën e zgjedhjeve. Partitë e opozitës patën pretendime për abuzime me certifikatat në disa NjQV.

B. NUMËRIMI I VOTAVE

Trajnimi i Grupeve të Numërimit (GN) filloi vonë, pavarësisht nga fakti se afati ligjor për propozimin e anëtarëve të GN-ve ishte sjellë më afër. Rrjedhimisht, shumë GN nuk ishin plotësisht të përgatitura për detyrat e tyre. Pas fillimit të numërimit, vëzhguesit raportuan se largësia midis zonës së caktuar për vëzhguesit dhe tryezave të numërimit pengonte vëzhgimin përshtatshëm të punës së GN-ve.

Pas mbylljes së votimit, kutitë e votimit u transportuan në 375 vende të numërimit të votave. Në tetë NjQV, votimi nuk u zhvillua, dhe, për pasojë, nuk pati numërim të votave.

Vëzhguesit raportuan se, në përgjithësi, marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore në vendet e numërimit të votave shkoi mirë. Pjesa më e madhe e problemeve u vërejt në NjQV-të e mëdha, ku shumë KQV mbërritën në të njëjtën kohë dhe iu desh të prisnin për të dorëzuar materialet e tyre zgjedhore. Marrja në dorëzim ishte e ngadaltë dhe e organizuar dobët në pjesën më të madhe të njësive bashkiake të Tiranës. Në të gjitha vendet e numërimit të votave të vëzhguara, numërimi i votave filloi vetëm pasi materialet zgjedhore ishin marrë nga të gjitha QV-të, siç parashikohet të Kodit Zgjedhor.

Ndonëse numërimi ishte i organizuar përgjithësisht mirë në pjesën më të madhe të vendeve të vëzhguara të numërimit të votave, emërimi i vonë i anëtarëve të grupeve të numërimit duket se çoi në trajnim të pamjaftueshëm të komisionerëve, dhe, rrjedhimisht, në gabime të bëra gjatë vetë procesit të numërimit.

Megjithëse pjesa më e madhe e grupeve të numërimit u përpoq të kryente detyrat me profesionalizëm, vëzhguesit e vlerësuan numërimin 'keq' apo 'shumë keq' në 23 për qind të raporteve të vëzhgimit të depozituara. Vetëm pak KZQV ishin në gjendje të përfundonin numërimin e votave, nxjerrjen e rezultateve dhe dërgimin e tyre në KQZ brenda afatit ligjor të orës 17:00 të datës 19 shkurt 2007.

Roli i luajtur nga partitë politike në disa NjQV pas ditës së zgjedhjeve ishte problematik. Në shumë vende të numërimit të votave, vëzhguesit vërejtën një numër më të lartë të vëzhguesve partiakë se ai i parashikuar në Kodin Zgjedhor dhe këta vëzhgues, shpesh, ndërhyjnë apo u përpoqën të ndërhyjnë në proces. Gjithashtu, prania e deputetëve nga të dy krahët në disa vende 'problematike' të numërimit të votave ndihmoi në rritjen e tensioneve dhe në një atmosferë më konfrontuese.

Në pak vende të numërimit të votave, numërimi i votave u karakterizua nga tensioni, dhe në disa raste ndodhën incidente të dhunshme. Në Gjirokastrë, numërimi u bllokua në mënyrë të përsëritur; në një rast, bllokimi erdhi pas një sherri me grushta midis mbështetësve të PS-së dhe PD-së brenda vendit të numërimit të votave. Në Bushat, numërimi u shty gjatë natës pas ditës së zgjedhjeve pas pengesave nga deputeti i zonës dhe mbështetësit e tij. Në Ndroq, numërimi degradoi në dhunë dhe dy komisionerë të opozitës u desh të shtroheshin në spital. Në disa njësi bashkiake të Tiranës, numërimi i votave nuk filloi deri në mëngjesin pas ditës së zgjedhjeve.

Në 19 për qind të vendeve të numërimit të votave të vizituara, u vunë re mosmarrëveshje në lidhje me vlefshmërinë e votave. Mosmarrëveshjet midis anëtarëve të grupeve të numërimit apo të KZQV-ve, ose midis grupeve të numërimit dhe KZQV-ve, çuan në çrregullime dhe ndërprerje

të procesit të numërimit. Në disa vende të numërimit të votave, numërimi u bllokua pasi komisionerë, që përfaqësonin interesa të ndryshme politike, u larguan. Në 38 për qind të vendeve të numërimit të votave të vëzhguara, u vërejt prania e personave të paautorizuar, dhe në rreth një të tretën e këtyre rasteve, këta persona ndërhyjnë në proces në mënyrë të pajustificuar. Më tej, vëzhguesit vunë re se persona të tjerë, përfshirë vëzhgues partiakë të autorizuar, u përpoqën të ndikonin në mënyrë të pajustificuar mbi grupet e numërimit apo KZQV-të.

Në një numër të kufizuar NjQV-shë, vëzhguesit raportuan se procesi i vendimmarrjes u bllokua nga grupet e numërimit apo KZQV-të. Në disa raste, KQZ-së iu desh të dërgonte inspektorët rajonalë apo trajnuesit e saj, për të ndihmuar KZQV-të të zgjidhnin problemet me numërimin e votave apo me nxjerrjen e rezultateve.

Në bashkinë e Himarës (Qarku Vlorë), mosmarrëveshjet mes kandidatëve të Partisë Demokratike dhe Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut mbi pretendimet për parregullsi në votime dhe përbërjen e grupeve të numërimit penguan procesin e numërimit që prej fillimit. Numërimi u zhvillua në një atmosferë të tensionuar dhe u ndërpre në mënyrë të përsëritur. Më 20 shkurt, KQZ-ja urdhëroi KZQV-në të përfundonte numërimin dhe dërgoi inspektorët e saj që të ndihmonin për zgjidhjen e problemeve. Në Himarë, u dërguan edhe përfaqësues të Prokurorisë së Vlorës. Përfundimisht, numërimi i votave në Himarë përfundoi të enjten, më 21 shkurt.

Në komunën e Bushatit (Qarku Shkodër), u numëruan vetëm kutitë e votimit të pesë prej 25 qendrave të votimit. KZQV-ja nuk mundi ta përfundojë numërimin për shkak të presionit nga një turmë mbështetësish të kandidatëve konkurrues për kryetarë komune, të cilët ishin grumbulluar jashtë vendit të numërimit të votave. Tubimi degradoi në dhunë dhe policisë iu desh të ndërhynte për të rivendosur rendin. Përfundimisht, KQZ-ja vendosi që i gjithë materiali zgjedhor të sillej në Tiranë dhe të numërohej aty nga KZQV-ja e Bushatit dhe nga dy grupe numërimi, në praninë e inspektorëve të KQZ-së.

Në bashkinë e Gjirokastrës, problemet qenë të dukshme edhe para se të fillonte numërimi i votave, pasi anëtarët e KZQV-së të propozuar nga shumica parlamentare nuk u paraqitën për të kryer numërimin. Numërimi nisi vetëm pasi një përfaqësues i KQZ-së u takua veçmas me secilin nga dy kandidatët kryesorë. Megjithatë, edhe pas kësaj, numërimi u zhvillua në një atmosferë të tensionuar dhe u ndërpre në disa raste. Pati, gjithashtu, një sherr me grushte mes anëtarëve të një grupi numërimi. Pas nxjerrjes të rezultateve për kryetarin e bashkisë më 21 shkurt, tensioni u ul. Numërimi i votave për këshillin përfundoi më 22 shkurt dhe rezultatet u nxorën të nesërmen.

Në komunën e Paskuqanit (Qarku Tiranë), KZQV-ja nuk e zbatoi vendimin e KQZ-së për vazhdimin e numërimit të votave. Më pas, KQZ-ja vendosi të shkarkonte kryetarin e KZQV-së dhe të bënte kallëzim penal për dhjetë anëtarë të KZQV-së. Përveç kësaj, të gjithë anëtarët e KZQV-së dhe sekretari u gjobitën secili me nga 30,000 lekë (rreth 240 Euro).

Në bashkinë e Durrësit, KZQV-ja nuk arriti të marrë vendim për rezultatin e zgjedhjeve për kryetar bashkie; anëtarët e propozuar nga shumica parlamentare votuan kundër hartimit të tabelës përmbledhëse të rezultateve, duke mos pranuar shpalljen si të pavlefshme të 1 189 fletëve të votimit gjatë numërimit. Më 23 shkurt, u firmos tabela përmbledhëse e rezultateve, por vetëm gjashtë anëtarët e propozuar nga pakica parlamentare votuan pro. Numërimi i votave për këshillin përfundoi më 25 shkurt.

Në bashkinë e Elbasanit, nxjerrja dhe dërgimi i rezultateve u pengua nga një polemikë mbi numërimin e një kutie votimi, sepse numri serial i njërës prej vulave me kodet e sigurisë të kutisë nuk përputhej me atë të shënuar në proces-verbalin zyrtar. Duke patur parasysh që KZQV-ja nuk

arriti të merrte një vendim mbi këtë kuti votimi, më 23 shkurt, KQZ-ja urdhëroi KZQV-në të transportonte të gjitha materialet zgjedhore dhe dokumentacionin në Tiranë.

Në komunën e Hekalit (Qarku Fier), ku procesi i numërimit u bllokua gjithashtu, më 23 shkurt, KQZ-ja urdhëroi KZQV-në të transportonte të gjitha materialet zgjedhore, përfshirë edhe kutitë e votimit, në mesin e KQZ-së, të shoqëruara nga personeli i KQZ-së.

Ditën e zgjedhjeve dhe gjatë gjithë procesit të numërimit, forcat e policisë vazhduan të kryenin detyrat e tyre në mënyrë profesionale. Ato arritën të ruajnë rendin në rrethana, të cilat, në disa raste, ishin të vështira, dhe përfshirja e tyre u thirr vetëm kur tensioni çoi në dhunë fizike. Vëzhguesit vunë re punën veçanërisht të lavdërueshme të policisë gjatë procesit të numërimit të votave në Gjirokastrë.

XVII. SHPALLJA E REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE

Kodi Zgjedhor nuk e rregullon çështjen e shpalljes së rezultateve paraprake. Natën e zgjedhjeve, KQZ-ja, nëpërmjet zëdhënësit të saj, dha informacione mbi rezultatet paraprake të zgjedhjeve për median, e cila i pasqyroi ato gjerësisht. Megjithatë, probleme të raportuara me *software*-in për hartimin dhe përpunimin e rezultatit të zgjedhjeve e penguan KQZ-në t'i nxirrte këto rezultate në faqen e saj të internetit natën e zgjedhjeve, megjithëse kishte marrë disa rezultate nga KZQV-të. Procesi i shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve u zvarrit dhe shumë prej rezultateve u shpallën shumë më vonë se afati ligjor i parashikuar në Kodin Zgjedhor. Dërgimi i rezultateve nga qendrat e mëdha urbane ishte veçanërisht i ngadaltë.

Deri më 25 shkurt, një javë pas datës së zgjedhjeve, KQZ-ja kishte shpallur rezultatet vetëm për 331 NjQV dhe i kishte mxjerrë në faqen e saj të internetit. Ndonëse pjesa më e madhe e KZQV-ve i kishte dërguar rezultatet për NjQV-të e tyre deri në atë fazë, dërgimi i rezultateve nga NjQV të tjera u vonua për shkak të mosmarrëveshjeve midis partive politike apo kandidatëve që penguan procesin e numërimit të votave si dhe nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve.

XVIII. ANKIMET DHE APELIMET PASZGJEDHORE

A. SHQYRTIMI I ANKIMEVE PASZGJEDHORE NGA KQZ-JA

Kodi Zgjedhor përcakton se subjektet zgjedhore kanë të drejtë të depozitojnë në KQZ kërkesa ankimore kundër vendimeve të KZQV-ve brenda tri ditëve pas marrjes së vendimit. KQZ-ja ka dhjetë ditë kohë për të marrë një vendim, i cili mund të apelohe në Kolegjin Zgjedhor brenda pesë ditëve. Numri i lartë i ankimeve ishte një sfidë për KQZ-në duke marrë parasysh kornizën kohore të parashikuar nga Kodi Zgjedhor për shqyrtimin e tyre.

Gjithashtu, subjektet zgjedhore mund t'i kërkojnë KQZ-së pavlefshmërinë e rezultatit të zgjedhjeve për një QV, një NjQV, ose të gjithë vendin, deri në tri ditë pas shpalljes së rezultateve nga KZQV-ja. Vendimet e KQZ-së kundër rezultatit të zgjedhjeve, mbi kërkesat për pavlefshmëri apo për kundërshtim të rezultatit të shpallur nga KZQV-të, kërkojnë një shumicë të cilësuar prej 6 nga 9 vota. Nëse pavlefshmëria e rezultateve të një ose më shumë QV-ve mund të ndikojë në ndarjen e mandateve, KQZ-ja mund të vendosë të urdhërojë përsëritjen e zgjedhjeve në NjQV-në përkatëse. Rezultatet e shpallura të pavlefshme pjesërisht nuk nënkuptojnë përsëritjen e zgjedhjeve, nëse KQZ-ja vendos se kjo pavlefshmëri nuk ka ndikim mbi ndarjen e mandateve.

KQZ-ja mori 251 ankime paszgjedhore. Nga këto, 152 ishin kundër vendimeve të KZQV-ve (apo mosmarrjes së vendimit) lidhur me rezultatet, and 93 ishin kërkesa për pavlefshmëri të disa QV-ve apo të një NjQV-je të tërë, ndërsa gjashtë ankime kishin të bënin me çështje të tjera. Mbi 100 ankime u pushuan për arsye procedurale, dhe mbi 90 u rrëzuan. Njëzetë e katër ankime u kthyen mbrapsht për plotësim dokumentacioni dhe 31 kërkesa ankimore u pranuan. Afërsisht gjysma e kërkesave për pavlefshmëri u depozituan nga dy partitë kryesore politike. Pjesa tjetër e kërkesave u depozituan nga kandidatë të pavarur apo forca të treta politike.

Megjithëse, një ndryshim në nenin 156 të Kodit Zgjedhor e lejon KQZ-në të marrë në konsideratë fakte, rrethana dhe ngjarje si provë, edhe nëse këto nuk janë të pasqyruara në ndonjë dokument zyrtar, KQZ-ja u mbështet kryesisht në dokumente të administratës zgjedhore dhe seanca dëgjimore me anëtarë të KZQV-ve. Në disa kërkesa për pavlefshmëri, kjo qasje, disi formale, duket të ketë parandaluar një shqyrtim më të plotë e të hollësishëm të rastit. Gjithashtu, KQZ-ja nuk i përdori kompetencat e saj, që iu shtuan së fundmi, për shqyrtim të rasteve kryesisht.

Në përputhje me Kodin Zgjedhor të ndryshuar, KQZ-ja hapi dhe kqyri 27 kuti (11 kuti votimi për kryetar, 1 kuti votimi për këshill dhe 15 kuti me materiale zgjedhore). Megjithëse në disa raste KQZ-ja numëroi fletët e votimit¹⁷, ajo urdhëroi në raste të tjera KZQV-të dhe GN-të përkatëse të vinin në Tiranë dhe të numëronin fletët e votimit të panumëruara.¹⁸

Në shumë raste, partitë dhe kandidatët nuk ishin në gjendje të siguronin ndonjë provë të qenësishme për të mbështetur pretendimet e tyre. Gjithsesi, në disa raste, ankimuesit vërtetuan se kishin ndodhur parregullsi domethënëse, veçanërisht gjatë numërimit ose nxjerrjes së rezultateve.

Megjithatë, me vazhdimin e procesit të ankimeve, pati raste të rëndësishme, ku anëtarë të KQZ-së votuan sipas vijave partiake, pavarësisht nga dispozitat e qarta ligjore. Gjatë periudhës paszgjedhore, puna e KQZ-së u ndikua nga kundërshti politike, konflikte personale dhe mungesë e frymës kolegjiale midis anëtarëve të saj. Në disa raste, disa anëtarë shfaqën synime për të ndërprerë apo penguar mbledhjet e KQZ-së.

Çështja e vlefshmërisë së përmbajtjes së kutive të votimit dhe përfshirja e tyre në rezultatet e NjQV-ve solli polemika, veçanërisht në një rast, kur pas shpalljes së përmbajtjes së dy kutive të votimit si të vlefshme, rezultati i këtyre dy kutive nuk u përfshi në tabelën përmbledhëse të rezultateve të NjQV-së¹⁹.

Së fundi, një numër i lartë ankimesh erdhën si rrjedhojë e vështirësive dhe gabimeve të hasura nga disa KZQV gjatë zbatimit të formualve të rirenditjes përfundimtare të kandidatëve në listat shumëmemërore të partive. KQZ-ja e mori në konsideratë mundësinë e rillogaritjes së tyre për të gjitha NjQV-të, por, në fakt, nuk e bëri një gjë të tillë.

B. SHQYRTIMET E APELIMEVE PASZGJEDHORE NGA KOLEGJI ZGJEDHOR

Pas ditës së zgjedhjeve, 106 vendime të KQZ-së u apeluar në Kolegjin Zgjedhor²⁰. Rreth gjysma e tyre kishin të bënin me pavlefshmërinë e zgjedhjeve në QV të veçanta apo në nivel NjQV-je, ndërkohë që pjesa tjetër përfshinte kryesisht ankime kundër rezultatit të zgjedhjeve dhe ndarjes së mandateve. Mbi 30 për qind e apelimeve u pranuan.

¹⁷ P.sh. për komunat Paskuqan dhe Shupenzë

¹⁸ P.sh. komuna Bushat

¹⁹ Komuna Hekal, QV-të 3137 dhe 3142

²⁰ D.m.th. 36 për qind e vendimeve të KQZ-së mbi ankimet paszgjedhore

Kolegji Zgjedhor pranoi nëntë apelime për pavlefshmëri të zgjedhjeve në QV të veçanta dhe urdhëroi ripërsëritje në nivel NjQV-je. Në tetë raste, këto ishin përsëritje të zgjedhjeve për kryetar NjQV-je²¹, dhe në një rast, zgjedhje për këshill²².

Sipas nenit 117 të Kodit Zgjedhor, vendimi për ripërsëritje të zgjedhjeve duhet marrë nga KQZ-ja dhe kërkon dy hapa të veçantë: së pari, zgjedhjet duhet të shpallen të pavlefshme në të paktën një QV të njësisë zgjedhore; së dyti, duhet vlerësuar ndikimi i mundshëm mbi ndarjen e mandateve. Megjithatë, me pranimin e apelimeve për pavlefshmëri të zgjedhjeve, Kolegji Zgjedhor e bëri vetë vlerësimin e mësipërm dhe urdhëroi ripërsëritje të zgjedhjeve aty ku vlerësoi se ishte e nevojshme. Me këtë veprim, Kolegji Zgjedhor i tejkaloi kompetencat e tij, meqenëse ripërsëritja mund të urdhërohet vetëm nga KQZ-ja.

Ankimet paszgjedhore nxorën në pah disa raste të mungesës së njëtrajshmërisë në qasjet e KQZ-së dhe Kolegjit Zgjedhor, në veçanti lidhur me ato situata ku QV të tëra u përjashtuan nga rezultati i zgjedhjeve në një NjQV por zgjedhjet nuk u shpallën të pavlefshme. Kështu, pati raste kur të gjitha fletët e votimit të një QV-je u shpallën të pavlefshme nga KQZV-ja (apo KQZ-ja) sipas nenit 109/4 të Kodit Zgjedhor dhe rezultatet e zgjedhjeve nuk u nxorën për atë QV dhe nuk përfshinë në rezultatet e NjQV-së. Kolegji Zgjedhor shpalli të pavlefshme zgjedhjet një QV ku të gjitha fletët e votimit qenë shpallur të pavlefshme, sepse u mungonte një vulë në anën e pasme, ndërkohë që KQZ-ja, më parë, kishte shpallur të pavlefshme vetëm fletët e votimit.²³ Megjithatë, në një rast tjetër identik, Kolegji Zgjedhor nuk e ndoqi këtë precedent të vënë prej tij. Konkretisht, ai rrëzoi një apelim dhe nuk shpalli pavlefshmëri të zgjedhjeve në asnjë prej QV-ve të Bashkisë Mamurras, pavarësisht nga fakti se tre QV ishin përjashtuar nga rezultatet e NjQV-së²⁴, ku të gjitha fletët e votimit në një QV ishin shpallur të pavlefshme, sepse mungonte një vulë në anën e pasme. Gjithashtu, Kolegji Zgjedhor pranoi dy apelime që kërkonin pavlefshmëri të zgjedhjeve në QV ku të gjitha fletët e votimit ishin shpallur të pavlefshme, sepse kundrafletët me numrat serialë ishin ende të pashkëputura nga fletët e votimit.²⁵

Pavlefshmëria e fletëve të votimit dhe shpallja e pavlefshme e zgjedhjeve kanë pasoja të ndryshme ligjore. Vetëm pavlefshmëria e fletëve të votimit nuk përbën parakusht për urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve, pavarësisht nga shkalla e saj, madje edhe kur numri i këtyre fletëve e tejkalon diferencën midis fituesit dhe ndjekësit. Siç tregoi edhe praktika në këto zgjedhje, pavlefshmëria e të gjitha fletëve të votimit në një QV, zakonisht shkaktohet nga gabime apo veprime të qëllimshme të zyrtarëve të zgjedhjeve. Nuk është e pranueshme që vullneti i zgjedhësve të një QV-je të tërë të shpërfillet dhe të hiqet nga rezultatet e zgjedhjeve vetëm për këtë arsye. Prandaj, pavlefshmëria e të gjitha fletëve të votimit në një QV duhet të specifikohet qartë si një prej arsyeve për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në QV-në përkatëse.

Pavarësisht nga fakti se zgjedhjet nuk ishin zhvilluar fare dhe, rrjedhimisht, u shpallën të pavlefshme nga KQZ-ja në një QV në Bashkinë Elbasan, me një numër zgjedhësish të regjistruar që tejkalonte diferencën e fituesit me ndjekësin në zgjedhjet për Kryetar bashkie²⁶, Kolegji

²¹ Në NjQV-të e mëposhtëme: Komunat: Kodovjat (Elbasan), Voskop (Korçë), Kelmend (Shkodër), Qendër (Vlorë), Komsî (Dibër), Hekal (Fier), Bushat (Shkodër) si dhe Njësia Bashkiake 10 në Tiranë.

²² Përsëritje për zgjedhjet për këshill u urdhëruan në komunat Qendër Çlirim (Fier) pas një apelimi nga Partia Balli Kombëtar, për moszbatim nga KQZ-ja të një vendimi të Kolegjit Zgjedhor para ditës së zgjedhjeve lidhur me përfshirjen e Partisë Balli Kombëtar në fletën e votimit.

²³ QV 3743, komuna Voskop

²⁴ QV-të 0911, 0917 dhe 0919, Bashkia Mamurras

²⁵ Në QV 2609 të Komunës Kodovjat dhe në QV 3142 të Komunës Hekal

²⁶ Ishin 860 zgjedhës të regjistruar në Listën Përfundimtare të Zgjedhësve të QV 2378 (ku zgjedhjet nuk u zhvilluan), ndërsa diferenca me fituesin (pas përfshirjes së një QV-je në rezultatet e NjQV-së nga Kolegji Zgjedhor) ishte 678 vota.

Zgjedhor nuk urdhëroi ripërsëritje të zgjedhjeve në NjQV, siç kishte vepruar në raste të ngjashme më parë. Në arsyetimin e rrëzimit të kërkesës për pavlefshmëri, iu referua pjesëmarrjes mesatare në zgjedhje në nivel NjQV-je (35%) dhe “mungesës së gjasave” që QV-ja e shpallur e pavlefshme të mund të përmbyste rezultatet e NjQV-së (kjo do të kërkonte pjesëmarrje prej 85 për qind të zgjedhësve në atë QV, me 100 për qind të votave në favor të kandidatit të renditur i dyti). Ky arsyetim ishte në mospërputhje me praktikën e mëparshme të Kolegjit Zgjedhor, dhe u duk t’i mungonte baza ligjore. Sipas nenit 117, pika 5 të Kodit Zgjedhor, mundësia e thjeshtë që rezultatet në një QV të shpallur të pavlefshme të mund të ndikojnë mbi ndarjen e mandateve është një parakusht i mjaftueshëm për të ripërsëritur zgjedhjet. KQZ-ja, përfundimisht, urdhëroi ripërsëritjen e zgjedhjeve në Bashkinë Elbasan në vendimin e saj për datën e përsëritjes së zgjedhjeve. Megjithatë vendimi ishte në përputhje me kompetencat e KQZ-së, ai u mor vetëm dy javë para datës së caktuar të zgjedhjeve, ndërkohë që koha në dispozicion për procesin e apelimit kundër këtij vendimi zgjat 15 ditë. Vendimi i KQZ-së për ripërsëritje të zgjedhjeve në Bashkinë Elbasan u apelua në Kolegjin Zgjedhor, i cili e rrëzoi.

Kolegji Zgjedhor pranoi pjesërisht një apelim të PS-së për kandidatin për kryetar në Njësinë Bashkiake 10 në Tiranë, e cila kishte kërkuar që, rezultatet e dy QV-ve²⁷, fillimisht të lëna jashtë tabelës përmbledhëse përfundimtare nga KZQV-ja dhe KQZ-ja, të përfshiheshin në rezultatet e përgjithshëm të NjQV-së. Konkretisht, Kolegji Zgjedhor vendosi të numërojë dhe vlerësojë fletët e votimit të një QV-je, nxori rezultatet e saj dhe e përfshiu atë në tabelën përmbledhëse të NjQV-së. Megjithatë, Kolegji Zgjedhor nuk u shpreh hapur për QV-në tjetër, e cila mbeti, kështu, jashtë rezultatit të NjQV-së. Rrjedhimisht, kandidatët e PS-së dhe PD-së për kryetarë të njësisë bashkiake morën numër të barabartë votash dhe fituesi u përcaktua me një short të organizuar nga KQZ-ja.²⁸ Megjithatë kërkesa e patrajtuar ende për pavlefshmëri të zgjedhjeve në NjQV u tërhoq nga pala ankuese, e cila ishte shpallur fituese, KQZ-ja vijoi me shqyrtimin e saj kryesisht, pasi gjykoi se vazhdimi i shqyrtimit të rastit ishte në interes të publikut²⁹. Meqë kërkesa për pavlefshmëri nuk arriti të marrë shumicën e cilësuar të nevojshme të anëtarëve të KQZ-së³⁰, ajo u rrëzua. Megjithatë, PD-ja e apeloj rrëzimin e kërkesës në Kolegjin Zgjedhor, i cili e pranoi apelimin dhe urdhëroi përsëritjen e zgjedhjeve.

Ankimet paszgjedhore konfirmuan, gjithashtu, shqetësimet e shprehura më parë lidhur me përdorimin e formulave për ri-renditjen përfundimtare të kandidatëve në listat shumëpartiake pas ditës së zgjedhjeve. Në një rast, një kandidat humbi të drejtën e tij, madje edhe për t’u marrë në konsideratë për ndarjen e mandateve, vetëm sepse QV-ja, e cila ishte ‘zona e tij e përgjegjësisë’ sipas marrëveshjes së partisë për rirenditjen përfundimtare, nuk ishte numëruar fare, pasi kutia e fletëve të votimit për zgjedhjet për këshill ishte shpallur e pavlefshme.³¹

Kolegji Zgjedhor i trajtoi apelimet në përgjithësi në mënyrë profesionale dhe transparente duke mundësuar debat dhe respektim të të drejtave procedurale të palëve. Megjithatë, qasja e tij nuk ishte gjithmonë e njëtrajtshme, siç edhe u përmend më sipër. Më tej, vendimet e tij u nxorën normalisht në formën e ‘vendimeve të shkurtuara’ të cilave u mungonte pjesa përshkruese-arsyetuese kërkuar nga neni 174/1 i Kodit Zgjedhor. Kolegji Zgjedhor shqyrtoi si të veçantë një

²⁷ QV 1985 dhe QV 1996, Njësia Bashkiake 10 në Tiranë.

²⁸ Kolegji Zgjedhor urdhëroi KQZ-në të hedhë short dhe specifikoi se shorti duhej të hidhej para shqyrtimit të kërkesës së pashqyrtuar ende së kandidatës së PS-së për pavlefshmëri të zgjedhjeve në krejt NjQV-në. Ky vendim përbëri ndërhyrje të pajustificuar në kompetencat e KQZ-së, pasi, sipas nenit 174 të Kodit Zgjedhor, Kolegji Zgjedhor mund të detyrojë KQZ-në të marrë vendim vetëm nëse mosmarrja e vendimit nga KQZ-ja brenda afatit të përcaktuar ligjor apelohej në Kolegjin Zgjedhor.

²⁹ Parashikuar nga neni 161/1 i Kodit Zgjedhor.

³⁰ Sipas nenit 30, pika 6 të Kodit Zgjedhor, këto kërkesa duhet të miratohen me gjashtë prej nëntë votave të anëtarëve të KQZ-së.

³¹ Vendim i KQZ-së Nr. 1425 dt. 28 shkurt 2007 dhe vendimi vijues i Kolegjit Zgjedhor i dt. 10 mars 2007 rrëzuan ankimin/apelimin përkatës nga Partia Aleanca Demokratike.

apelim dhe rrëzoi kërkesën formale të një partie politike për 'sqarim dhe interpretim' të një vendimi të tillë të shkurtuar³²; në këtë rast, nxjerrja në kohë e tekstit të plotë të vendimit të Kolegjit Zgjedhor do ta kishte zgjidhur problemin.

XIX. ZGJEDHJET E PËRSËRITURA, 6 MAJ 2007

Më 6 maj 2007³³, zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore u përsëritën në 20 NjQV³⁴, d.m.th. në rreth 5 përqind të të gjitha NjQV-ve të Shqipërisë. Ato përfshinë tetë përsëritje të zgjedhjeve si për kryetarin e NjQV-së ashtu dhe për këshillin³⁵, dhjetë përsëritje të zgjedhjeve vetëm për kryetarin³⁶, si dhe dy raste të zgjedhjeve vetëm për këshillin³⁷.

Emërimet e vonuara dhe zëvendësimet e shumta të anëtarëve të KZQV-ve, KQV-ve³⁸ dhe GN-ve ishin përsëri të shpeshta, të iniciuara në një numër rastesh nga vetë kandidatët dhe jo nga partitë politike.³⁹ Përsëri, afatet ligjore për emërimet u injoruan shpesh⁴⁰. Emërimi i anëtarëve të KQV-ve u përfundua vetëm një ditë para datës së zgjedhjeve. Shumica e Grupeve të Numërimit (GN-ve) u emëruan disa orë pas mbylljes së votimit.

KQZ-ja kreu përgatitjet për përsëritjet në përputhje me Kodin Zgjedhor. Pati përmirësime bazuar në mësimet e nxjerra nga zgjedhjet e 18 shkurtit, të tilla si dorëzimi i materialeve zgjedhore komisionerëve gjatë sesioneve të trajnimit të tyre, ose orientimi⁴¹ i NJQV-ve për përgatitjen e kopjeve të Regjistrimit të Posaçëm dhe shpërndarjen e një numri të konsiderueshëm kopjesh KZQV-ve në kohën e duhur.

Votimi ishte përgjithësisht i qetë. Hapja e votimit ishte në përgjithësi e rregullt, me disa raportime për vonesa në hapjen e disa QV-ve⁴². Në Shalë, dy QV nuk u hapën fare pasi anëtarët e QV-ve nuk u paraqitën. Dita e votimit u njollosh nga tensioni dhe akuzat për intimidimin e komisionerëve dhe zgjedhësve në komunën Pult⁴³, ku persona të armatosur u panë në QV ose në afërsi të tyre. Në Njësinë Bashkiake 10 në Tiranë, votimi në një QV u ndërpre herë pas here.⁴⁴

Ndonëse u vonua për shkak të emërimit të vonuar të GN-ve, numërimi u krye përgjithësisht në mënyrë të kënaqshme dhe në kohë. Megjithatë, procesi u bllokua në Lurë, ku KQZV-ja mori vendim për mosnumërimin e votave, pa arsye ligjore. KQZ-ja shkarkoi tetë anëtarë të KZQV-së dhe paraqiti kallzim penal kundër tyre. KZQV-ja e Pultit nxori rezultatet duke numëruar vetëm

³² Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut kërkoi sqarim të vendimit të Kolegjit Zgjedhor të dt. 20 mars 2007, me anë të të cilit Kolegji Zgjedhor kishte pranuar apelimin e saj për pavlefshmëri të zgjedhjeve në një QV të komunës Qendër (Vlorë), por duke urdhëruar edhe ripërsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë NjQV-në, gjë që nuk ishte kërkuar nga apeluesi.

³³ Data për përsëritjen e zgjedhjeve u vendos nga KQZ me Vendimin Nr. 1683, dt 22 prill 2007.

³⁴ Zgjedhjet e u përsëritën në 12 NjQV dhe u zhvilluan për herë të parë në 8 NjQV të tjera.

³⁵ Në komunat Lurë, Libofshë, Arren, Milot, Iballë, Pult, Shalë dhe Shosh.

³⁶ Në komunat Gjerbës, Shupenzë, Koms, Hekal, Voskop, Kelmend, Bushat, Qendër-Vlorë dhe Kodovjat, si dhe në Njësinë Bashkiake nr. 10, Tiranë

³⁷ Në komunat Qendër-Çlirim dhe Qendër Malësi e Madhe

³⁸ KQZ mori 55 vendime për emërimin dhe zëvendësimin e anëtarëve të KQV-ve (përfshi 26 për KZQV-të e reja të komunave Hekal dhe Shupenzë).

³⁹ Në një numër prononcimesh publike, KQZ-ja publikisht u bëri thirrje partive politike për të përmbushur detyrimet e tyre në lidhje me ngritjen e administratës zgjedhore.

⁴⁰ Sipas nenit 45, pika 2 i Kodit Zgjedhor, KQV-të duhet të emërohen jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve.

⁴¹ Vendimi Nr. 1685 i dt. 24 prill 2007.

⁴² Në Pult dhe Njësinë Bashkiake 10, Tiranë.

⁴³ QV-ja nr. 0093 u hap por votimi nuk u zhvillua. Në QV-në nr. 0094 votimi vazhdoi deri afër mesditës, kur dikush vodhi vulën e Kryetarit.

⁴⁴ QV nr. 1999.

dy nga gjashtë QV-të. Në Njësinë Bashkiake 10 në Tiranë, rezultatet e dy QV-ve nuk u përfshinë në tabelën përmbledhëse të rezultateve.

Në një zhvillim pozitiv, KQZ-ja siguroi paraqitjen në kohë reale të rezultateve paraprake në faqen e saj të internetit, pasi kishte përmirësuar programin kompjuterik pas dështimeve të hasura gjatë zgjedhjeve të datës 18 shkurt.

XX. REKOMANDIME

Rekomandimet e mëposhtëme ofrohen për t'u marrë në konsideratë nga autoritetet, partitë politike dhe shoqëria civile e Republikës së Shqipërisë, si mbështetje e mëtejshme për përpjekjet e tyre për të zhvilluar zgjedhje në përputhje me Angazhimet e OSBE-së dhe standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Një numër i këtyre rekomandimeve janë ofruar edhe më parë në raporte të mëparshme përfundimtare të OSBE/ODIHR-it, por mbeten ende për t'u trajtuar. OSBE/ODIHR-i mbetet i gatshëm për të ndihmuar autoritetet dhe shoqërinë civile të Shqipërisë për përmirësimin e mëtejshëm të procesit zgjedhor.

A. PARTITË POLITIKE

1. Partitë politike duhet të shfaqin vullnet politik për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike në përputhje me privilegjet e gjera që u janë dhënë atyre nga ligji, përsa i përket zhvillimit të zgjedhjeve.
2. Për të siguruar që partitë të mund të konkurrojnë me njëra-tjetrën mbi baza të barabarta, siç kërkohet nga paragrafi 7.6 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së, dispozitat e Kodit Zgjedhor që bëjnë dallime mes partive politike duhet të hiqen.
3. Duhet të parashikohen mekanizma efektivë zbatimi për dispozitat që kanë të bëjnë me raportimin pranë KQZ-së të shpenzimeve të fushatës nga garuesit.
4. Duhet marrë në konsideratë bërja publike e raporteve të shpenzimeve të fushatës së partive. Kjo mund të nxisë transparencën financiare të fushatave zgjedhore, duke rritur kështu besimin në proces.
5. Duhet rregulluar mungesa e njëtrajtshmërisë midis neneve 144 dhe 145/1 të Kodit Zgjedhor për të siguruar njëtrajtshmëri të mëtejshme në dispozitat për financimin e fushatës.
6. Duhet marrë në konsideratë forcimi i mekanizmave institucionalë për monitorimin e keqpërdorimit të mundshëm të burimeve administrative dhe rasteve të blerjes së votes dhe vënja e shkelësit para përgjegjësisë. Organizatat shqiptare mund të luajnë një rol në këtë drejtim.

B. KUADRI LIGJOR

7. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor duhet të jenë fryt i një reforme zgjedhore të plotë ndërmarrë në kohë të mjaftueshme para zgjedhjeve. Ndryshimet e vonuara të kuadrit ligjor zgjedhor duhet të shmangen pasi bien ndesh me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe e vendosin administratën zgjedhore para sfidave shtesë.

C. SISTEMI ZGJEDHOR

8. Rirenditja apo renditja “përfundimtare” e kandidatëve nga subjektet zgjedhore pas hedhjes së votës, duhet rishqyrtuar. Kodi Zgjedhor duhet ndryshuar për të garantuar që partitë politike të vendosin dhe të shpallin, para zgjedhjeve, renditjen sipas së cilës do të bëhet shpërndarja e mandateve për kandidatët e tyre, me qëllim që të sigurohet që zgjedhësit të jenë të informuar paraprakisht për kandidatët që ka të ngjarë të marrin mandatin si rrjedhojë e mbështetjes së tyre për një parti apo koalicion të veçantë.

D. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

9. Ndërkohë që ruan transparencën dhe gjithëpërfshirjen për formimin dhe funksionimin e administratës zgjedhore, Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet me qëllim eliminimin e çdo hapësire për abuzim dhe bllokim të procesit nga partitë politike. Në veçanti, duhet të ketë mekanizma efektivë për të plotësuar vendet bosh në administratën zgjedhore në rast se partitë nuk e ushtrojnë të drejtën e tyre për propozim brenda afateve të përcaktuara.
10. Me qëllim sigurimin e pavarësisë dhe profesionalizmit të administratës zgjedhore, mundësia e zëvendësimeve arbitrare të zyrtarëve të zgjedhjeve nga partitë politike duhet të ndërpritet. Kodi Zgjedhor mund të lejojë largimin dhe zëvendësimin e anëtarëve të administratës zgjedhore vetëm mbi baza të parashikuara qartë e të renditura në mënyrë të qartë e të plotë në ligj.
11. Neni 22 i Kodit Zgjedhor mbi procedurat e zgjedhjes së anëtarëve të KQZ-së duhet të silltet në përputhje me Kushtetutën, me qëllim që të mos ofrojë mundësi për të kufizuar të drejtën kushtetuese të institucioneve emëruese.
12. Llogaridhënia e komisionerëve zgjedhorë ndaj niveleve më të lartë në administratën zgjedhore duhet të forcohet. Komisionerët japin llogari para niveleve më lartë në administratën zgjedhore dhe jo para partive që i kanë propozuar.
13. Duhet marrë në konsideratë ulja e anëtarësisë në komisionet zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së këtyre komisioneve. Kjo gjen zbatim edhe për grupet e numërimit.
14. Trajnimi i anëtarëve të KZQV-ve, KQV-ve dhe GN-ve duhet të intesifikohet dhe përmirësohet. Duhet marrë në konsideratë përfshirja në Kod e dispozitave që parashikojnë trajnime dhe kualifikime të avancuara të organizuara nga KQZ-ja, që do të mundësonin ngritjen e një grupi me zyrtarë zgjedhorë të trajnuar dhe të certifikuar, të cilët do të kishin përparësi në rekrutim në procese zgjedhore.
15. Roli dhe kompetencat e Zyrave Zgjedhore në qarqe duhet të përkufizohet në Kodin Zgjedhor.
16. Duhet marrë në konsideratë me përparësi fuqizimi i KQZ-së me anë të rritjes së kapaciteteve administrative si dhe me anë të burimeve të mjaftueshme e të qendrueshme financiare.

E. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

17. Legjislacioni zgjedhor (parësor apo dytësor) duhet të parashikojë kritere të qarta dhe objektive si dhe qasje për shqyrtim uniform dhe të barabartë për verifikimin e firmave

mbështetëse të zgjedhësve për regjistrimin e kandidatëve. Këto krietere duhet të përcaktohen shumë kohë para periudhës së shqyrtimit. Nëse administrata zgjedhore duhet ta përmbushë detyrën me efektshmëri, asaj i duhet dhënë më shumë kohë në dispozicion për shqyrtimin e firmave mbështetëse.

18. Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet për të specifikuar se numri i firmave mbështetëse të nevojshme për listat e këshillave i referohet listës si një e tërë, dhe jo çdo kandidati të veçantë në këtë listë. Formulimi aktual është i paqartë dhe u interpretua në kuptimin që numri i përcaktuar për firmat mbështetëse kërkohej për çdo kandidat në listën për këshill.
19. Në rastet kur firmat mbështetëse është e qartë që janë falsifikuar, duhen zbatuar masa ndëshkuese. Administratës zgjedhore duhet t'i kërkohej të njoftojë partitë, kur merret një vendim për zbatimin e tyre. Të gjitha partive u duhet dhënë kohë për të ndrequr gabime teknike në dokumentacionin mbështetës.

F. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE DHE IDENTIFIKIMI I TYRE

20. Për ta përmirësuar më tej saktësinë e listave të zgjedhësve, përpjekjet e vazhdueshme për të përmirësuar saktësinë e regjistrave të gjendjes civile jo vetëm që duhet të vazhdojnë, por duhet të intensifikohen më tej.
21. Kjo detyrë do të kërkojë një angazhim afatgjatë të organeve qendrore dhe vendore, nëse autoritetet shqiptare dëshirojnë një sistem plotësisht funksional të gjendjes civile dhe të regjistrimit të zgjedhësve në kohën e duhur për zgjedhjet për Kuvendin të parashikuara për vitin 2009.
22. Shumë mangësi në proces, përfshirë ato për regjistrimin e zgjedhësve, rrjedhin nga mungesa e kapaciteteve të administratës shqiptare në veçanti në Qarqe. Të gjitha Zyrat e Gjendjes Civile në gjithë vendin duhen kompjuterizuar dhe duhet krijuar një rrjet midis tyre dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në Ministrinë e Brendshme me qëllim mundësinë për shkëmbim në kohë reale të të dhënave midis të gjitha ZGjC-ve dhe DPGjC-së.
23. Deri në dhënien e dokumenteve të identitetit dhe për sa kohë certifikatat e lindjes përdoren si mjete identifikimi, Zyrat e Gjendjes Civile duhet të vazhdojnë të mbajnë të dhëna të sakta të të gjitha certifikatave të lëshuara, në veçanti për qëllime zgjedhore, dhe këto të dhëna duhet të bëhen të disponueshme për publikun.
24. Prodhimi dhe lëshimi i kartave të reja të identitetit për shtetasit duhet të mbështetet në një sistem të modernizuar dhe funksional të gjendjes civile dhe të adresave.

G. MEDIA

25. Minutazhi me pagesë duhet t'u sigurohet të gjitha partive politike mbi baza jodiskriminuese, pavarësisht nga pesha e mëparshme zgjedhore. Në këtë rast, duhet marrë në konsideratë mundësia e vendosjes së kufijve për minutazhin total me pagesë të blerë nga secila parti.
26. KQZ-ja duhet të ndërmarrë hapa për sigurimin e përmirësimit të bazës metodike dhe procedurave të Bordit të Monitorimit të Medias, në shkallë vendi dhe në nivel vendor. Përfaqësuesit vendorë të BMM-së duhet të emërohen në kohë dhe t'u jepen të gjitha pajisjet dhe dokumentacioni i nevojshëm për të përmbushur si duhet detyrat e tyre.

27. Duhet zbatuar masa për shkeljet e heshtjes zgjedhore zyrtare para ditës së zgjedhjeve.
28. Meqenëse zgjedhjet vendore dhe referendumat nuk është e detyrueshme të zhvillohen ditën e dielë, të gjitha afatet lidhur me fushatën dhe median në Kodin Zgjedhor duhet të përcaktohen në lidhje me datën e zgjedhjeve dhe jo t'u referohen ditëve specifike të javës.
29. Duhet ndërmarrë hapa për të siguruar dhe nxitur transparencën e pronësisë së medias.

H. VOTIMI DHE NUMËRIMI

30. Duhet siguruar respektimi më i mirë i procedurave të votimit nga KQV-të, veçanërisht lidhur me procedurat për përdorimin e bojës shenjuese në gishtin e zgjedhësit apo identifikimin e zgjedhësve, me anë të trajnimit të duhur dhe sanksioneve të mundshme.
31. Rregullat lidhur me praninë e personave në qendrat e votimit dhe vendet e numërimit duhen zbatuar rreptësisht. Në veçanti, duhet siguruar që vetëm personat e autorizuar të jenë të pranishëm në vendet e numërimit të votave. Numri i vëzhguesve partiakë duhet kufizuar sipas parashikimeve të ligjit dhe duhen lejuar vetëm ata që mbajnë një akreditim të përcaktuar.
32. Rregullat lidhur me përdorimin e telefonave celularë dhe mjeteve të tjera të komunikimit duhen zbatuar me më shumë rreptësi, veçanërisht gjatë numërimit të votave.
33. Ka vend për përmirësim të transparencës së numërimit. Të gjithë garuesit në zgjedhje duhet të lejohen të vëzhgojnë numërimin mbi baza të barabarta. Përpjekje të qenësishme duhen bërë për të përmirësuar mundësinë që vëzhguesit të vëzhgojnë saktësinë e numërimit.

I. ANKIMET DHE APELIMET

34. KZQV-të dhe KQV-të kanë nevojë për direktiva më të qarta për kompetencat e tyre në shqyrtimin e ankimeve dhe për sigurimin e një qasjeje të njëtrajtshme.
35. Duhet marrë në konsideratë ndryshimi i nenit 153 të Kodit Zgjedhor për të përmendur palën e paditur në shqyrtimin administrativ të një kërkesë ankimore, duke patur parasysh të drejtat procedurale të palës së paditur dhe përkufizimin përkatës në nenin 90 të Kodit të Procedurës Civile.

J. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

36. Transparenca mund të rritet më tej duke lejuar vëzhguesit vendas të regjistrohen më herët se 45 ditë para ditës së zgjedhjeve.
37. Vendet e Numërimit të Votave duhet të organizohen në mënyrë të tillë që vëzhguesit të mund të ndjekin si duhet numërimin e votave (për shembull, largësia midis hapësirës së rezervuar për vëzhguesit dhe tryezave të numërimit nuk duhet të jetë aq e madhe sa që të bëjë të pamundur një vëzhgim të mirëfilltë).

K. Pjesëmarrja e Grave

38. Duhet marrë në konsideratë trajnimi i mëtjshëm i komisionerëve zgjedhorë lidhur me çështjen e votimit familjar, me qëllim zvogëlimin e problemit në të ardhmen.
39. Partitë politike duhet të ndërmarrin nisma më të mëdha të përqendruara më shumë te femrat me anë të programeve dhe veprimtarive të tyre.
40. Qeveria dhe Kuvendi duhet të shohin mundësi për rritjen e pjesëmarrjes së grave në jetën publike.

L. Pjesëmarrja e Pakicave Kombëtare

41. Në përgatitjen e regjistrit të ri kombëtar të gjendjes civile, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar grupeve vulnerabël të pakicave kombëtare. Qeveria duhet të sigurojë që këto grupe të regjistrohen si duhet për të votuar.
42. Praktika e përpjekjes për të ndikuar mbi votën me anët të metodave të blerjes së saj në bashkësi të tilla vulnerabël duhet trajtuar në të gjitha nivelet për ta çrrënjësuar atë.
43. Fushatat e KQZ-së për informimin e zgjedhësve duhet të shtrihet për të gjitha grupet e pakicave, në mënyrë të fokusuar.
44. Autoritetet duhet të zbatojnë Planin e Veprimit të OSBE-së për popullsitë rome dhe sinti, në veçanti kapitullin VI “nxitja e pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike”.

RRETH OSBE/ODIHR-it

Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që ndihmon shtetet pjesëmarrëse “të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, shtetit të së drejtës dhe për të promovuar parimet e demokracisë dhe (...) për të ndërtuar, forcuar dhe mbrojtur institucionet demokratike, si dhe të promovojë tolerancën në të gjitha nivelet e shoqërisë” (Dokumenti i Helsinkit 1992).

ODIHR-i, me seli në Varshavë, Poloni, u krijua si Zyra për Zgjedhje të Lira në Samitin e Parisit në vitin 1990 dhe filloi funksionimin në maj 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për të pasqyruar një mandat më të gjerë për të përfshirë të drejtat e njeriut dhe demokratizimin. Sot, për të punojnë mbi 100 vetë.

ODIHR-i është organizmi kryesor në Europë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Ai bashkërendon dhe organizon dërgimin e mijëra vëzhguesve çdo vit për të vlerësuar nëse zgjedhjet në zonën e OSBE-së janë në përputhje me legjislacionin vendas dhe standartet ndërkombëtare. Metodologjia unike siguron një vështrim në thellësi të të gjithë elementëve të një procesi zgjedhor. Me anë të projekteve të asistencës, ODIHR-i ndihmon shtetet pjesëmarrëse të përmirësojnë kuadrin e tyre zgjedhor.

Veprimtaritë e Zyrës për **demokratizim** përfshijnë fushat tematike të mëposhtme: shteti i së drejtës, shoqëria civile, liria e lëvizjes, barazia gjinore dhe trafikimi i qenieve njerëzore. ODIHR-i zbaton një numër programesh të caktuara asistencë çdo vit, duke kërkuar si lehtësimin ashtu edhe mbështetjen në përmbushjen e angazhimeve të OSBE-së nga vendi pjesëmarrës dhe të zhvillojë struktura demokratike.

ODIHR-i monitoron shtetet pjesëmarrëse në përmbushjen e angazhimeve të OSBE-së lidhur me dimensionin njerëzor dhe ndihmon në përmirësimin e të **drejtave të njeriut**. Gjithashtu, organizon disa takime çdo vit për të rishikuar zbatimin e angazhimeve të OSBE-së lidhur me dimensionin njerëzor nga shtetet pjesëmarrëse.

ODIHR-i këshillon shtetet pjesëmarrëse mbi politikat e tyre për komunitetet **rome dhe sinti**. Zyra nxit rritjen e kapaciteteve dhe lidhjen në rrjet mes komuniteteve rome dhe sinti, si dhe pjesëmarrjen e përfqësuesve romë dhe sinti në organet politikëbërëse. Zyra punon, gjithashtu, për shkëmbimin e informacionit mbi çështjet rome dhe sinti midis aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Të gjitha veprimtaritë e ODIHR-it zhvillohen në bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë me shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, institucionet dhe veprimet në terren të OSBE-së, si dhe me organizma të tjerë ndërkombëtarë.

Informacione të mëtejshme mund të gjeni në faqen e internetit të ODIHR-it (www.osce.org/odihr).